

INSTITUTI I
STUDIMEVE
POLITIKE

ANKETIM ME GRATË DEPUTETE

KUVENDI I SHQIPËRISË 2019-2020



Kingdom of the Netherlands

DEPUTETIM.al





Kingdom of the Netherlands



GRATË DEPUTETE

ROLI, MODELE DHE SFIDA TË PËRFAQËSIMIT

ANKETIM

KUVENDI I SHQIPËRISË
2019-2020

Projekti për monitorimin e Kuvendit (shtator 2017-shtator 2020) realizohet nga Instituti i Studimeve Politike www.isp.com.al me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta. Në funksion të projektit është realizuar aplikacioni online www.deputetim.al ku reflektohen të dhënat e vazhdueshme të monitorimit.

**Opinionet e shprehura në këtë studim nuk përfaqësojnë
opinionet e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta**

BOTUES

Instituti i Studimeve Politike

EKIPI REALIZUES

Drejtues i projektit

Afrim Krasniqi

Ekipi i ekspertëve

Brunilda Duriçi

Rudina Niklekaj

Juljana Bilbilaj

Borana Elezi

Kristos Bratja

Kopertina

M&P Studio

ISBN ISBN 978-9928-4592-4-4

© Instituti i Studimeve Politike, Tiranë 2020

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: www.isp.com.al

E-mail: contactaips@isp.com.al

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. GJETJET KRYESORE
 - 1.1. REKOMANDIME
 - 1.2. RAPORTET E ISP, GRATË DEPUTETE ME BILANC POZITIV PËRFAQËSIMI

 2. PROFILI POLITIK I GRAVE DEPUTETE
 - 2.1. ANGAZHIMI I MËPARSHËM? 46% VIJNË NGA KARRIERAT POLITIKE
 - 2.2. MBI 60%, MË SHUMË SE 10 VJET PËRVOJË POLITIKE
 - 2.3. GRATË DEPUTETE DHE BESNIKËRIA NDAJ PARTISË POLITIKE
 - 2.4. GRATË DEPUTETE DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE / KONFLIKTEVE POLITIKE
 - 2.5. MËNYRA E PËRZGJEDHJES PËR KANDIDIM NË ZGJEDHJET 2017
 - 2.6. SISTEMI I KARRIERËS: BAZË SISTEMI I KUOTAVE DHE MBËSHTETJES NGA LIDHJA?
 - 2.7. DY TË TRETAT E GRAVE MBËSHTETESIN SISTEMIN E MERITËS & AFTËSISË
 - 2.8. KARRIERA PAS MBARIMIT TË MANDATIT PARLAMENTAR?
 - 2.9. ANGAZHIMI NË POLITIKË? SHUMICA MIDIS 2-6 ORË

 3. ANGAZHIMI NË AKTIVITETIN PARLAMENTAR
 - 3.1. BILANCI I TRAJNIMEVE TË OFRUARA NGA KUVENDI
 - 3.2. NEVOJA PËR TRAJNIM DHE ÇËSHTJET PËRKATËSE
 - 3.3. NIVELI I NISMAVE LIGJORE NGA GRATË DEPUTETE
 - 3.4. MOTIVET PENGUESE PËR NISMA LIGJORE
 - 3.5. ANGAZHIMI JAVOR NË AKTIVITETIN PARLAMENTAR
 - 3.6. RAPORTI MIDIS ANGAZHIMIT POLITIK DHE ATIJ PERSONAL/FAMILJAR
 - 3.7. FORMA E KONSULTIMIT TË LIGJEVE NË KUVEND
 - 3.8. NDJESITË NDAJ FUNKSIONIT, VOTIMIT DHE VENDIMMARRJEVE POLITIKE
 - 3.9. NEVOJAT E DEPUTEVEVE PËR TË QENË MË EFEKTIVE NË PARLAMENT
 - 3.10. VLERËSIMI PËR NËN KOMISIONIN MBI BARAZINË GJINORE NË KUVEND
 - 3.11. GRATË DEPUTETE DHE DISKRIMINIMI NDAJ TYRE NË KUVEND
 - 3.12. MBËSHTETJA E PARTIVE ME KONSULTIME/ASISTENCË NDAJ GRAVE DEPUTETE
 - 3.13. LEGJISLACION PËR RRITJEN E PËRFAQËSIMIT GJINOR?
 - 3.14. RAPORTI I GRAVE DEPUTETE ME FORUMET E GRAVE NË PARTITË POLITIKE
 - 3.15. RAPORTI ME ALEANCËN E GRAVE DEPUTETE
 - 3.16. ALEANCA E GRAVE DEPUTETE SI INSTRUMENT PROMOVIMI PËR GRATË POLITIKANE?
 - 3.17. REKOMANDIME E SFIDA PËR ALEANCËN E GRAVE DEPUTETE

 4. LIDHJA ME ZONËN, ZGJEDHËSIT DHE PUBLIKUN
 - 4.1. PËRFAQËSIMI NË ZONË? PREFERENCA DHE DELEGIMI NGA PARTIA
 - 4.2. ZGJEDHJE APO EMËRIM NË ZONËN ELEKTORALE?
 - 4.3. TRI SHQETËSIMET KRYESORE PËR VOTUESIT MESHKUJ – FEMRA
 - 4.4. FTESA DHE TAKIME NË AKTIVITETET PUBLIKE
 - 4.5. FAKTORË PENGUES PËR LIDHJE TË FORTË ME ZONËN ELEKTORALE
 - 4.6. TË DISKRIMINUARA NË FUSHATË?
 - 4.7. METODAT MË EFEKTIVE PËR KOMUNIKIM ME ELEKTORATIN
 - 4.8. LOGJISTIKA MBËSHTETËSE DHE MJETET E KOMUNIKIMIT PUBLIK
 - 4.9. PIKËPAMJET E GRAVE MBI DISA PËRCEPOTIME PUBLIKE RRETH TYRE
 - 4.10. ÇFARË DUHET NDRYSHUAR? LOBIMI, KUOTAT DHE PRURJET NË POLITIKË
 - 4.11. SUGJERIME NDAJ MONITORIMIT / AKTIVITETEVE TË ISP

 5. SHTOJCË: PËRMBAJTJA E PLOTË E ANKETIMIT
-

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pjesëmarrja e grave në jetën parlamentare përbën një standard të rëndësishëm për demokracinë përfaqësuese, cilësore dhe funksionale. Shqipëria e periudhës së tranzicionit ka përvoja të ndryshme në përfaqësimin gjinor parlamentar. Pas vendosjes së sistemit të kuotave, në kandidim në zgjedhjet parlamentare ka pasur rritje graduale të numrit të grave deputete. Trendi përfaqësues është ruajtur edhe në proceset e zëvendësimeve dhe ndryshimeve që kanë ndodhur në përbërjen e parlamentit. Raportimet profesionale të standardeve të përfaqësimit edhe në partitë politike, në vendimmarrjen politike lokale dhe në institucionet politike kryesore në vend, nxjerrin në pah risi dhe problematika, mangësi dhe rekomandime, pika takimi dhe ndarjeje edhe me bilancin e përfaqësimit në parlament.

ISP ka realizuar më parë studime profesionale mbi përfaqësimin gjinor në politikë, ku më kryesoret janë: Risitë dhe problematikat e përfaqësimit gjinor në zgjedhje (2015) dhe Standardet e përfaqësimit Politik (2017), dy studime të mbështetura nga Un Women Albania.

Instituti i Studimeve Politike (ISP) realizoi në qershor-korrik 2019 një anketim me 90% të grave deputete në parlamentin aktual si dhe me 10% të grave deputete të opozitës që dorëzuan mandatet parlamentare në shkurt 2019. Anketimi bëhet në kuadër të projektit për monitorimin e parlamentit 2017-2020, të cilin ISP po e realizon me mbështetjen financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë. Përgjigjet e anketimit janë anonime, 35% e tyre janë përmes komunikimit me e-mail, 54% përmes plotësimit nga vetë deputetet/ish deputetet dhe 11% përmes komunikimit direkt të stafit të ISP me deputeten.

Për realizimin e tij u angazhuan stafi monitorues i ISP në parlament, shumica e të cilëve kanë pasur përvoja të tjera profesionale anketimi dhe sondazhesh të zhvilluara në kundër të ISP apo nismave të tjera. Një mbështetje për realizimin e tij ishin drejtuesit e Aleancës së Grave Deputete, zv/kryetarja e Kuvendit, si dhe drejtuesit e grupeve parlamentare në Kuvend. ISP falënderon tri politikane me përvojë parlamentare, të cilat dhanë vlerësime paraprake mbi përmbajtjen e anketimit, strukturën dhe elementë të tjerë profesionalë të tij, gjithashtu edhe stafin e ambasadës holandeze për asistencën e ofruar në elementë të veçantë të inicimin apo hartimin e anketimit.

Qëllimi i anketimit është analiza të gjithë faktorëve më të rëndësishëm që lidhen me karrierën politike të grave deputete, aktivitetin parlamentar, komunikimin me zgjedhësit, cilësinë e përfaqësimit, çështjen e kuotave dhe të raporteve me organizatat e grave në partitë politike, etj. Të dhënat e paraqitura në këtë kërkim, pas prezantimit me Aleancën e Grave Deputete, do t'u vihet në dispozicion partive politike parlamentare, institucioneve politike në vend, OJF-ve që merren me të drejtat e njeriut, zgjedhjet dhe përfaqësimin politik, si edhe partnerëve ndërkombëtarë në Shqipëri.

Ne besojmë se gjetjet dhe rekomandimet do të ndihmojnë në rritjen e përfaqësimit politik gjinor, në përmirësimin e standardeve të përfaqësimit dhe në adresim të problematikave të mundshme në institucionet përgjegjëse për rrugëzgjdhje sa më efektive.

1. GJETJET KRYESORE

- ❖ Nga gratë deputete të legjislativës aktuale mbi 30% nuk kanë përvojë të mëparshme politike drejtuese në parlament, në parti politike ose në qeverisjen lokale. Mbi 60% e grave deputete kanë më shumë se një dekadë përvojë politike. Mbi 80% e tyre nuk kanë ndryshuar asnjëherë parti politike dhe të gjitha e lidhin besnikërinë ndaj partisë më besimin tek programi politik i saj.
- ❖ Gratë deputete janë më të prirura për të ndjekur rrugën ligjore, sesa mbrojtjen përmes partisë në përballjen me akuza dhe situata konfliktuale. 93% besojnë tek hetimet nga drejtësia dhe 87% tek përgjegjësia për të sqaruar publikun dhe elektoratin, ndërkohë që vetëm 29% kërkojnë mbështetje politike dhe 14% janë të gatshme të bëhen pjesë e debatit në media.
- ❖ 89% e grave deputete besojnë se janë në parlament për shkak të dy faktorëve, - mbështetjes nga kryetari i partisë dhe mbështetjes nga baza e partisë. Asnjë prej tyre nuk ka vetë-kandiduar. Mbi 60% e grave deputete u është caktuar zona elektorale nga partia politike dhe vetëm 16% e kanë zgjedhur vetë atë. Ato e shohin hyrjen e tyre në parlament si rezultat të dy faktorëve, sistemit të kuotave gjinore dhe mbështetjes nga lideri partiak, - një tregues i natyrës së sistemit aktual zgjedhor e partiak, ku rol përcaktues ka partia jo individi.
- ❖ Dy të tretat e grave deputete e shohin zgjidhjen afatgjatë të karrierës politike përmes një sistemi të meritës dhe vlerësimit mbi aftësitë, jo zgjidhje të imponuara nga linja vertikale e emërimit apo përfitimi nga kuotat. Gratë vlerësojnë negativisht rivalet e tyre politike dhe sistemin përmes të cilit ato janë zgjedhur, pavarësisht se i njëjti sistem vlen për të gjitha palët politike në Kuvend.
- ❖ 75% e grave deputete nuk mendojnë dorëheqjen nga politika megjithëse 100% e grave deputete mendojnë se në jetë kanë profesion më të mirë sesa ai i politikanës. 93% kanë vendosur të rikandidojnë në zgjedhjet e radhës dhe 83% duan të vijojnë angazhimin në partinë politike.
- ❖ Gratë deputete i kushtohen politikës dhe partisë së tyre politike mesatarisht 2-6 orë në ditë dhe mbi 13 orë në javë, kurse jetës parlamentare mesatarisht 3-4 orë në ditë. Kurba e kohës së angazhimit politik është horizontale, ku përqindja e grave me angazhim 2-3 orë në ditë është i barabartë me ato që angazhohen 10-15 orë në javë.
- ❖ Tre të pestat e grave deputete kanë ndërmarrë nisma ligjore ose kanë propozuar amendime të ndryshme ligjore gjatë aktivitetit në parlament. Dy pengesat kryesore për më shumë nisma ligjore janë mungesa e stafit asistues legjislativ dhe mungesa e ekspertizës personale.
- ❖ Dy të tretat e grave deputete vlerësojnë se angazhimi politik është pengesë kryesore ose e pjesshme për angazhimet e tjera personale dhe familjare.

- ❖ Në procesin e konsultimeve mbi ligjet që votohen në Kuvend gratë deputete deklarojnë se procesin konsultues dhe informues e marrin përmes angazhimit në komisione dhe informacionit nga Kuvendi. Vetëm gjysma e grave deputete ka mundësi të bëjnë konsultime paraprake me zgjedhësit për ligjet në axhendë dhe akoma më pak realizojnë konsultime me ekspertë të jashtëm të fushës.
- ❖ Mbi 47% deklarojnë se janë ndjerë të pafuqishme për të ndryshuar gjërat në vend, një në pesë gra deputete pranojnë që kanë votuar ligje për të cilat pasur qëndrime personale kritike dhe rreth 13% kanë pranuar se kanë deklaruar edhe për gjëra që ato vetë nuk i besojnë
- ❖ Shumica (53%) deklarojnë se janë ndierë viktimë e medias dhe fake news, 19% nuk janë ndjerë të parespektuara nga kolegët, një në pesë gra ndjehet e abuzuar për shkak të pamjes ose të veshjes apo për shkak të mendimit kritik politik.
- ❖ 36% e grave deputete ndjehen të diskriminuara plotësisht ose pjesërisht për shkak të gjinisë në aktivitetin e tyre parlamentar dhe një në katër gra ndjehen të injoruar për shkak të konfliktualitetit dhe klimës politike.
- ❖ Për të rritur efektivitetin e tyre gratë deputete e shohin zgjidhjen tek promovimi më i madh i parimeve gjinore, tek njohja më e mirë e Kushtetutës dhe ligjeve, si dhe tek mbrojtja publike e mendimeve dhe ideve që ato mbrojnë/promovojnë.
- ❖ Megjithëse ngritja e nënkomisionit për barazinë gjinore në Kuvend është tregues pozitiv, gjysma e grave deputete kanë qëndrime kritike ndaj bilancit dhe efektivitetit të punës së tij. dy të tretat e grave bëjnë përgjegjës edhe mungesën e kapaciteteve asistuese dhe buxhetit për aktivitete, më shumë se gjysma kritikojnë kuvendin dhe grupet parlamentare për mbështetje të pamjaftueshme ndaj tij.
- ❖ Një e treta e grave nuk bëjnë konsultime në parti dhe as përfitojnë nga asistenca e tyre cilësore në funksion të përgjegjësive parlamentare të deputetëve, por mbi 80% e tyre mendojnë se gratë deputete kanë potencial të mjaftueshëm për të promovuar rritjen e përfaqësimit gjinor përmes nismave ligjore.
- ❖ Tri shqetësimet prioritare të zgjedhësve në zonat elektorale si për votuesit femra dhe meshkuj janë papunësia e lartë, vështirësitë me punësimin e të rinjve dhe mangësitë në sistemin e edukimit / arsimit.
- ❖ Faktorët kryesorë që e bëjnë të vështirë lidhjes me zonat elektorale janë rastet kur zona ka nivel të lartë varfërie dhe kur pushteti lokal në zonë drejtohet nga partia rivale politike.
- ❖ Më shumë se gjysma e grave deputete ndjehen të diskriminuara në fushatë në aspektin e retorikës politike dhe mungesës së mjeteve financiare. Dy herë më shumë është numri i grave që i kapërcen pengesat me durim dhe angazhim më të madh, në raport me ato që tërhiqen përpara pengesave/situatave të vështira për të shmangur konfliktin ose përshkallëzimin.

- ❖ Gratë deputete mendojnë se metoda më e mirë e komunikimit me elektoratin është ajo e kontaktit direkt dhe përmes komunikimit me telefon. Përdorimi i mediave sociale për komunikim me elektoratin është popullor në vetëm gjysmën e grave deputete
- ❖ Të gjitha gratë deputete deklaruan se nuk kanë financim të mjaftueshëm për aktivitete, 87% deklaruan se nuk kanë sponsorizimeve nga mbështetësit e partisë politike dhe 63% deklaruan se nuk kanë këshilltarë për asistimin e aktivitetit të tyre
- ❖ 94% mendojnë se gratë politike janë më pak të inkriminuara sesa burrat dhe se ato kanë sjellë ndryshime pozitive për vendin, 65% janë kritike ndaj vlerësimit se ato janë më shumë produkte kuotash sesa meritash dhe 59% mendojnë se mjedisi politik është paragjykes për gratë në karrierë
- ❖ Lidhur me sfidat e ardhshme, 100% e grave deputete kërkojnë më shumë lobim për rritjen e përfaqësimit gjinor, forcim të organizatave të grave dhe promovim të modeleve pozitive. 88% mendojnë se duhet aplikuar kuota e detyrueshme për parlamentin dhe 81% mendojnë se duhet penguar hyrja e “të fortëve” dhe “biznesmenëve” në politikë
- ❖ Rreth 80% e grave deputete janë anëtare aktive apo pjesërisht aktive në forumet/organizatat e grave në partitë e tyre politike, si dhe shumë më tepër janë pjesë e Aleancës së Grave Deputete (AGD). Shumica besojnë se AGD nuk promovon sa duhet gratë politike. Tre sfidat kryesore të AGD janë aktiviteti mbipartiak, nismat ligjore promovuese për gratë dhe mbështetja aktive për gratë në politikë. Gratë deputete kërkojnë buxhet të dedikuar dhe rol më aktiv të AGD për ta bërë atë më aktive dhe më me ndikim në misionin e saj.

1.1. REKOMANDIME

- ❖ Kuvendi duhet të përmbushë përgjegjësitë e tij për trajnime të vazhdueshme të deputetëve dhe të krijojnë një axhendë trajnimi periodike që përputhet me nevojat reale dhe me funksionet thelbësore ligjvënëse.
- ❖ Kuvendi duhet të mbështesë AGD me buxhet të dedikuar dhe me asistencë më të qëndrueshme profesionale dhe legjislativë.
- ❖ AGD duhet mbështetur dhe forcuar në komponentin e ndërveprimit mbi ndarjet politike, si dhe si një mekanizëm efikas për promovimin e modeleve pozitive dhe karrierës së grave në parlament dhe në jetën politike të vendit.
- ❖ Partitë politike parlamentare duhet të forcojnë organizatat e tyre të grave, të kenë buxhet të veçantë për to dhe të nxisin konkurrencën brenda tyre mbi bazën e një sistemi meritokracie dhe vlerësimi të kontributeve publike.

- ❖ Grupet parlamentare duhet të miratojnë rregullore dhe norma etike të brendshme, të cilat mundësojnë eliminimin e cdo forme diskriminimi për shkak të gjinisë dhe përfaqësimit e barabartë të gjinive në të gjithë strukturat e tyre drejtuese dhe përfaqësuese.
- ❖ Reforma zgjedhore duhet të marrë në konsideratë nevojën e kalimit nga kuota kandidimi në kuota zgjedhore në parlament. Përmes sistemit të kuotave të nxitet një klimë mbështetëse për prurjet e reja në politikë, rritjen e konkurrencës dhe cilësisë së përfaqësimit, duke harmonizuar meritat profesionale, aftësitë dhe mbështetjen politike.
- ❖ Shoqëria civile dhe media, organizatat ndërkombëtare dhe donatorë të ndryshëm në raport me Kuvendin dhe partitë politike duhet ta trajtojnë me prioritet nevojën e rritjes së përfaqësimit gjinor shumëplanësh në vendimmarrjen politike.
- ❖ Kuvendi, grupet parlamentare dhe partitë politike duhet të zhvillojnë anketime të vazhdueshme për të kuptuar më mirë problematikat e brendshme dhe çështjet e përfaqësimit, si mënyrë e njohjes më të mirë të gjendjes dhe bazë për ofrimin e rrugëzgjdhjeve përmirësuese për të ardhmen.
- ❖ Kuvendi, grupet parlamentare dhe partitë politike duhet të zgjerojnë rrethin e ekspertizës së jashtme profesionale në funksion të procesit legjislativ, si dhe të sigurojnë asistencë ligjore të vazhdueshme për gratë deputete dhe deputetët e tjerë.
- ❖ Kuvendi, grupet parlamentare dhe partitë politike mund e duhet të bëjnë akoma më shumë për edukimin më të thelluar ligjor të kandidatëve për deputetë, për evitimin e prurjeve problematike (të fortët/dekriminalizimi/biznesmenët) dhe për krijimin e një klime mbështetëse për individë me potenciale profesionale e politike.
- ❖ Gratë deputete mund e duhet të jenë më solidare dhe bashkëvepruese si në promovimin e politikave gjinore dhe rritjen e përfaqësimit, ashtu edhe në kërkesat për standarde më të larta të aktivitetit parlamentar për veten e kolegët e tyre.

1.2. RAPORTET E ISP, GRATË DEPUTETE ME BILANC POZITIV PËRFAQËSIMI

Raportet monitoruese të ISP gjatë viteve 2017-2020 vazhdimisht kanë nxjerr në pah faktin se gratë deputete kanë qenë më aktive sesa deputetët e tjerë dhe se ato kanë qenë në krye të klasifikimit të efikasitetit tek shumica e grupeve parlamentare.

Konkretisht, në raportin e fundit monitorues (janar-gusht 2019) gra deputete ishin në krye të klasifikimit të efikasitetit në grupin e PS-së, PD-së dhe LSI-së (edhe pas daljes nga parlamenti të dy partive të fundit).

Në vlerësimin e përgjithshëm të raporteve periodike 2017-2018-2019 rezulton se në 16 vendet e para të deputetëve me vlerësimin më të lartë 8 janë gra deputete, pra në nivel 50% nga përfaqësimi aktual prej 29% i grave në përbërjen e parlamentit.

Në raportin e fundit monitorues (shtator-dhjetor 2019) në 22 deputetët më efektivë në renditje ishin 30% gra, përqindje më e lartë sesa përqindja që gratë deputetë zënë në parlament. Në total gratë deputete kishin vlerësim mesatar të efikasitetit në kuotën 33% ndaj 31% të gjinisë tjetër, si dhe po ashtu 2% më shumë angazhime edhe në debatet në komisionet parlamentare.

DEPUTETE PARA DHE PAS 2019

1	Albana Vokshi	1	Adelina Rista
2	Adelina Rista	2	Almira Xhembulla
3	Almira Xhembulla	3	Amra Barova
4	Antoneta Dhima	4	Antoneta Dhima
5	Blerina Gjylameti	5	Ardiana Jaku
6	Dhurata Çupi	6	Artemis Dralo
7	Edlira Bode	7	Aurora Mara
8	Eglantina Gjermani	8	Blerina Gjylameti
9	Elena Xhina	9	Ediola Braha
10	Elisa Spiropali	10	Edlira Bode
11	Elona Gjebrea	11	Edlira Hyseni
12	Ermonela Felaj	12	Eglantina Gjermani
13	Evis Kushi	13	Elda Hoti
14	Fatbardha Kadiu	14	Elena Xhina
15	Floida Kërpaçi	15	Elisa Spiropali
16	Grida Duma	16	Elona Gjebrea
17	Izmira Ulqinaku	17	Enada Kapllani
18	Jorida Tabaku	18	Ermonela Felaj
19	Kejdi Mehmetaj	19	Evis Kushi
20	Klajda Gjoshë	20	Fatjona Dhimitri
21	Klodiana Spahiu	21	Klodiana Spahiu
22	Klotilda Bushka	22	Klotilda Bushka
23	Lindita Metaliaj	23	Lindita Nikolla
24	Lindita Nikolla	24	Majlinda Halilaj
25	Milva Ekonomi	25	Milva Ekonomi
26	Mimi Kodheli	26	Mimi Kodheli
27	Mirela Kumbaro	27	Mirela Kumbaro
28	Monika Kryemadhi	28	Ogerta Manastirliu
29	Nadire Meçorapaj	29	Olta Xhaçka
30	Nora Malaj	30	Reme Lala
31	Ogerta Manastirliu	31	Rudina Hajdari
32	Olta Xhaçka	32	Senida Mesi
33	Orjola Pampuri	33	Suzana Topi
34	Reme Lala	34	Tatjana Piro
35	Rudina Hajdari	35	Vasilika Hysi
36	Senida Mesi	36	Vilma Bello
37	Silva Caka		
38	Tatjana Piro		
39	Valentina Duka		
40	Vasilika Hysi		
41	Vilma Bello		

Në vlerësimin edhe të ish deputeteve (PD+LSI) aktualisht jashtë parlamentit, gratë deputete ishin në krye të listës për nivelin e angazhimit politik dhe publik. Edhe në vlerësimin e treguesve të angazhimit të ministrave në aktivitetin parlamentar, në krye të renditjes ndodhen gra ministre.

Në botimin e fundit të ISP mbi dekriminalizimin rezulton se asnjë grua deputete dhe kryetare bashkie nuk ka qenë objekt i ndëshkimit ose hetimit në kuadër të dekriminalizimit dhe se numri i grave këshilltare të larguara është mbi 50% më i vogël sesa i këshilltarëve meshkuj.

Të dhënat e mësipërme janë vetëm një segment nga një analizë e gjatë dhe komplekse e nivelit të përfaqësimit politik në aspektin e përfaqësimit gjinor, si dhe e faktit se masat ligjore mbështetëse, siç ishte sistemi i kuotave të kandidimit në zgjedhjet parlamentare dhe lokale, ka rezultuar me bilanc pozitiv në aspektin sasior dhe cilësor.


Për efekt të dokumentimit të këtij publikimi, në tabelat bashkëngjitur janë paraqitur lista e grave deputete në dhjetor 2019 (deputetet aktuale) dhe lista e grave deputete, të cilat si pjesë e vendimmarrjes politike të partive të tyre dorëzuan mandatet parlamentare në shkurt 2019. Disa prej këtyre të fundit ishin pjesë e anketimit, edhe për shkak të nevojës që anketimi të jetë sa më përfaqësues dhe që gjetjet të reflektojnë një bazë sa më të gjerë të përfaqësimit të grave në politikë.

2. PROFILI POLITIK I GRAVE DEPUTETE

Të dhënat mbi profilin politik kanë rëndësi për të vlerësuar më qartë identitetet politike në parlament, lidhjen me partitë politike, karrierën politike dhe elementë të tjerë përfaqësues. Gratë deputete të dala nga zgjedhjet parlamentare 2017 vinin nga parti të ndryshme politike (PS, PD, LSI, PDIU), ndërkohë që me largimin e opozitës kryesore dhe krijimin e një grupeve të reja në parlament, ato bëjnë pjesë në secilin prej grupeve aktuale (PS, Demokrat, Të Pavarur, etj).

2.1. ANGAZHIMI I MËPARSHËM? 46% VIJNË NGA KARRIERAT POLITIKE


Legjislatura aktuale parlamentare është hartuar mbi bazën e sistemit proporcional me lista të mbyllura, ku partitë politike kanë rol përcaktues për kandidimin dhe promovimin e kandidatëve për deputetë. Individët e pavarur dhe ata që mund të jenë kritikë brenda partive të tyre kanë shanse minimale të jenë pjesë e listës proporcionale dhe në rast përfshirje, kanë shanse minimale të jenë në zonën fituese të listës. Ndaj edhe ishte e rëndësishme për të testuar se cila është përvoja e mëparshme politike e grave deputete, së paku dy vjet përpara zgjedhjes në parlament.



Të dhënat dëshmojnë se mbi 46% e deputetëve të përfshira në anketim vijin me karrierë të mëparshme politike, duke qenë kandidate ose të zgjedhura si deputete, si kryetare bashkie apo si anëtare të këshillit bashkiak. Një në katër deputete ka qenë kandidate dhe rreth një në pesë deputete ka qenë e zgjedhur.

Përqindja e prurjeve të reja në politikë, kryesisht nga angazhimi në shoqërinë civile, si dhe e grave që nuk kanë pasur angazhim politik gjatë dy viteve të fundit është gjithashtu e lartë, respektivisht në një gjashtë deputete (17%).

Në total, 34-35% e grave deputete janë prurje të reja pa përvojë direkt politike. Pjesa e deputeteve që kanë qenë aktiviste (jo drejtuese) në partitë politike është rreth 10%, kurse një minimum i grave deputete kanë dhënë përgjigje të tjera që lidhen kryesisht me përvojën e kombinuar ose në poste administrative .




Nga 25% e grave deputete, të cilat kanë qenë kandidatë në dy vitet e fundit për një post të lartë (deputete, kryetare bashkie, këshilltare bashkiake, etj), 60% kanë qenë deputete ose kandidatë për deputete. Kategoria e dytë më e madhe është e grave që nuk kanë pasur poste partiake dhe as nuk kanë kandiduar në vitet 2015-2017 në zgjedhjet parlamentare ose lokale. Kategoritë e tjera kanë janë në kuota minimale.


2.2. MBI 60%, MË SHUMË SE 10 VJET PËRVOJË POLITIKE

Në pyetjen adresuar grave deputete se sa vite kanë angazhime në parti politike (anëtare, kandidatë, etj), të dhënat janë interesante. Kategoritë dominuese janë ato me kontribut 10-29 vjet, ndërkohë që kategoritë që përfshijnë vitet e fundit (1-4) janë në kuota minimale. Konkretisht, vetëm 4% kanë përvojë partiake 1-2 vjeçare, po aq sa edhe ata me përvojë 29 vjeçare në parti politike. Kategoria me më shumë angazhime janë deputetet me 10 vjet përvojë politike (18%), si dhe ato me përkatësisht 6, 9 dhe 15 vjet në politikë (secila me nga 11%).

Fakti se pjesën dominuese e zënë gratë deputete me përvojë të gjatë në partitë politike vjen në kundërshtim me konceptin e prurjeve të reja jashtë politikës që partitë e mëdha prezantojnë pothuajse në çdo proces zgjedhor. Një pjesë e konsiderueshme e prurjeve rezulton të ketë qenë nga brenda vetë anëtarësisë. Nga ana tjetër, PS është prej 6 vitesh në pushtet / PD prej 6 vitesh në opozitë, ndërkohë që vetëm 26% e grave deputete kanë përvojë 1-7 vjeçare, pra pjesa tjetër prej më se 74% i përket grave që kanë qenë anëtare përpara sesa PD të kalonte në opozitë dhe PS të vinte në pushtet.



Në tërësinë e tyre gratë deputete deklarohen se janë besnike të partive të tyre politike. Vetëm 14% e grave në anketim kanë deklaruar se kanë ndryshuar parti politike dhe kryesisht kjo përqindje lidhet me gratë deputete që përbëjnë opozitën e sotme parlamentare, pra që janë larguar ose përjashtuar nga dy partitë kryesore në opozitë, PD e LSI, ose kanë ndryshuar angazhimin në një prej partive të mëdha duke u angazhuar në ndonjë prej partive të vogla, të cilat më 2017 ishin pjesë e koalicionit me partitë e mëdha.




Në parlamentin aktual, në dallim nga legjislaturat e mëparshme, ka pasur disa gra deputete që janë përjashtuar (nuk dorëzuan mandatet në shkurt 2019 ose pranuan hyrjen në parlament pas bojkotit politik PD e LSI) ose kanë ndryshuar parti politike (PDIU). Në tërësi në tranzicion, rastet kur gratë deputete krijojnë fraksione ose ndryshojnë parti politike janë shumë të pakta.

2.3. LIDHJA ME IDENTITETIN POLITIK: PËRSE I JANË BESNIKE PARTISË?

Një prej treguesve të identitetit politik është raporti midis angazhimit në një parti politike dhe bindjeve personale ndaj partisë. Gratë deputete u pyetën rreth arsyeve kryesore që i kanë nxitur ato të jenë pjesë e partive politike ku adresojnë. Pyetjet ishin të përcaktuara në anketim dhe asnjë prej përgjigjeve nuk ishte jashtë këtyre pyetjeve.

Nga të dhënat e anketimit lidhur me pyetjen nëse arsye kryesore e angazhimit në partinë politike është nevoja për të siguruar një status më të mirë social, ndarja është e balancuar, 50% e konfirmojnë këtë argument dhe 50% e refuzojnë atë. Në lidhje me bindjen se partia e tyre politike do të mund të ndryshojë gjendjen në vend, 83% besojnë tek aftësia e partisë së tyre politike për të ndryshuar gjendjen, shifër gati e njëjtë me 86% të grave deputete që i qëndronin besnike partisë së tyre politike.




Në lidhje me argumentin se bashkimi me partinë ka ndodhur si një mjet për të ndikuar në promovimin e tyre në karrierë, dy të tretat e grave deputete e konfirmojnë atë, një e treta e refuzon. Së fundi, është gjithashtu interesante se të gjitha gratë në anketim theksojnë se besojnë shumë tek program dhe parimet politike të partisë së tyre, - një tregues i lidhjes së fortë midis atyre si individ dhe partisë së tyre politike, por edhe i brishtësisë në raport me identitetin politik.

Kjo e fundit shprehet sidomos në faktin se një numër jo i vogël grash deputete (17%) kanë ndryshuar partinë politike, pra kanë zgjedhur së paku dy programe politike të ndryshme dhe se shumica e partive politike në vend, përfshirë disa parti të përfaqësuara direkt ose indirekt në parlament (nga listat proporcionale) nuk kanë pasur dhe as kanë program politik dhe elektoral në dy zgjedhjet e fundit lokale e parlamentare.

2.4. GRATË DEPUTETE DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE / KONFLIKTEVE POLITIKE

Në vlerësimin mbi reagimin që duhet të bëjnë gratë deputete në raste kërcënimesh apo përfshirjesh në skandale, përgjigjet janë gjithashtu interesante: 93% mendojnë se është më mirë t'i adresohen prokurorisë për hetime ndaj kërcënimeve dhe dy të tretat (67%) zgjedhin opsionin t'i drejtohen avokatit personal për të bërë kallëzim penal.

Nga ana tjetër, vetëm 14% janë të gatshme t'a bëjnë kërcënimin publik dhe të përfshihen në politika publike përmes medias për çdo rast kërcërimi apo akuze. Lidhur me rastet e përfshirjes në ndonjë skandal, 87% mendojnë se rruga më e mirë është t'i drejtohen elektoratit të tyre dhe publikut për sqarime, dhe se vetëm 29% mendojnë se duhet kërkuar mbështetja e partisë së vet për raste të tilla.




Fakti se 57% nuk e shohin zgjidhjen tek adresimi i shqetësimit tek partia e vet politike është tregues i rritjes së maturisë politike dhe i faktit se gratë deputete përgjithësisht i konsiderojnë akuzat dhe kërcënimet për shkak të funksionit si një çështje me të cilën mund të përballen edhe vetë.

2.5. MËNYRA E PËRZGJEDHJES PËR KANDIDIM NË ZGJEDHJET E VITIT 2017

Gratë deputete u pyetën mbi mënyrën sesi janë përzgjedhur kandidatet për deputete nga forca e tyre politike më 2017. Pyetjes nëse ato kanë pranuar kërkesën e bazës për kandidim në zgjedhje 89% shprehën konfirmuese megjithëse sistemi aktual zgjedhor nuk krijon lidhje të fortë midis kërkesave të bazës partiake dhe vendimmarrjes finale në listën proporcionale.

Në lidhje me pyetjen nëse vetë ato kanë aplikuar për kandidim për deputete përgjigjia është surprizë, asnjë prej grave në anketim nuk ka aplikuar vetë për të kandiduar, - një përqindje që nuk e gjen pothuajse në asnjë prej modeleve të partive moderne në PES dhe EPP. Ambicia e kandidimit është tipar normal për individët që duan të kenë angazhim politik dhe kanë pasion politikën, megjithatë përgjigjia mund të shihet edhe e kushtëzuar nga sistemi aktual i zgjedhjes së kandidatëve, i cili nuk bazohet tek vetë-kandidimi, por tek preference e partisë.


Në lidhje me pyetjen nëse emërimi i tyre në listën proporcionale ka qenë vendim i vetë kryetarit të partisë, 89% janë konfirmuese, - tregues që shpreh sistemin vertikal të përzgjedhjes dhe të vendimmarrjes në partitë politike me sistemin aktual zgjedhor. Nga ana tjetër gratë deputete kanë konfirmuar në 71% të rasteve se kanë qenë produkt i një gare konkurruese brenda partisë politike, - një vlerësim që duhet të merret me rezerve për sa kohë zgjedhja e deputetëve më 2017 në listat proporcionale nuk është bërë përmes garës konkurruese brenda partiake në asnjë prej partive politike.



2.6. SISTEMI I KARRIERËS: BAZË SISTEMI I KUOTAVE DHE I MBËSHTETJES NGA LIDERI?

Gratë deputete u pyetën më pas për sistemin e vlerësimit / meritokracisë për gratë politike në partitë politike ku ato aderojnë ose kanë aderuar.

Në total vetëm 13% konfirmojnë se zgjedhja e grave deputete bëhet përmes shitblerjes së postit/mandatit, megjithatë nga përgjigjet vijuese në këtë rast dhe në pyetje të tjera është e qartë se asnjë grua nuk e konfirmon këtë problematikë kritike për partinë e saj politike, por e artikulon për palën tjetër rivale politike.




Rreth 88% e grave deputete vlerësojnë se përzgjedhja e grave në partitë politike bëhet bazuar në aftësinë e tyre profesionale dhe për shkak të sistemit të meritës. Kjo është, një kuotë e lartë, por e diskutueshme për sa kohë CV-të profesionale dhe koncepti i meritës mund të paraqiten në forma e standarde të ndryshme vlerësimi në profesione, grupmosha dhe prurje të ndryshme.


Dy përgjigje kanë kuotat maksimale, - njëra që e sheh përfaqësimin e grave deputete si produkt të sistemit të kuotave gjinore të kandidimit në partitë politike dhe në proceset zgjedhore, si dhe vlerësimi se në çdo rast zgjedhja bëhet me miratim e mbështetje nga lideri politik i partisë. Faktori më pak i kuotuar në përgjigjet e anketimit lidhet me rolin e lidhjeve personale dhe familjare në kandidim, për të cilin kanë dhënë votën pro rreth një e treta e grave deputete, ndaj dy të tretave kundër.

2.7. DY TË TRETAT E GRAVE MBËSHTETESIN SISTEMIN E MERITËS & AFTËSISË

Në pyetjen më të zgjeruar se cili prej faktorëve ka qenë më përcaktues në karrierën e tyre politike, 66% ose dy të tretat votojnë për meritat personale dhe aftësinë profesionale. Sistemi i kuotave në partitë politike dhe në zgjedhjet parlamentare është vlerësues si faktor përcaktues në 15% të rasteve, ndërkohë që 12% kanë një vlerësim miks midis sistemit të kuotave dhe sistemit të meritës profesionale.



Kur deputetet pyetën për treguesit kryesore mbi të cilat është bazuar karriera politike e grave në partinë rivale politike përgjigjet ndryshojnë. Konkretisht sistemit të meritës dhe të aftësive i jepet vetëm vlerësim 26% nga 66% që i jepej në partinë e vet; lidhja midis meritës dhe kuotës gjinore merr 31% të vlerësimit, kuotën më të lartë vlerësuese për rivalët politike.




Në total, 17% merr vendimmarrja e liderit të partisë rivale, 15% merr mbështetja personale apo familjare në parti dhe 5% japin përgjigje të tjera alternative.

Vlera e krahasimit të dy përgjigjeve, për treguesit e karrierës në partinë e tyre dhe më pas edhe në partinë e rivalëve të tyre politikë, vlen për të kërkuar e gjetur korrelacion midis të njëjtëve faktorë në dy rastet ose mbi perceptimin që gratë deputete kanë për veten dhe rivalët politike.

2.8. KARRIERA PAS MBARIMIT TË MANDATIT PARLAMENTAR?

Cili do të jetë angazhimi i ardhshëm pas mbarimit të mandatit të kësaj legjislature? Kësaj pyetjeje gratë deputete iu përgjigjën në forma të ndryshme, por asnjë prej tyre nuk deklaroi se është e gatshme të dorëhiqet nga politika. 75 % e të pyeturave nuk kanë vendosur ende se çfarë do të bëjnë në të ardhmen, 80% janë të sigurt se do të kenë angazhime në të ardhmen në botën universitare ose në shoqërinë civile.



Në lidhje me karrierën politike 83% mendojnë se do të vijojnë aktivitetin brenda partive të tyre politike dhe 93% do të donin të konkurronin përsëri në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Shifra prej 93% është mjaft e lartë dhe një tregues indirekt edhe se vetë gratë deputete ndiejnë se kanë pasur suksese në politikë në përfaqësimin e deritanishëm, suksese mbi të cilat mbështetet edhe dëshira për të vijuar aktivitetin legjislativ në parlament.



Së fundi, ka një paradoks në përgjigjen, - ndonëse 93% duan të mbeten në parlament dhe asnjë nuk mendon dorëheqjen nga politika, përsëri 100% e grave deputete mendojnë se në jetën jashtë politikës kanë profesion shumë më të mirë sesa ai i politikanes. Natyrisht, nëse ky pohim qëndron atëherë është gati e pakuptueshme këmbëngulja për të vijuar ende në politikë.

2.9. ANGAZHIMI NË POLITIKË? SHUMICA MIDIS 2-6 ORË

Deputetet u pyetën se sa kohë u merr angazhimi i tyre në politikë. Konkretisht, lidhur me orët mesatare në ditë në aktivitete politike rezultoi se një e treta e tyre i kushton 4 deri në 6 orë në ditë politikës dhe axhendës së aktiviteteve politike, 20% i kushton 7 deri në 9 orë dhe 12% i kushton madje 13 deri në 15 orë. Në kategoritë me shumë angazhime politike nuk futet vetëm angazhimi në komisione dhe në seanca plenare, por edhe në aktivitete protokollare politike, aktivitete partiake si dhe aktivitete mediatikë me statusin e deputetesh dhe të politikanes.



Nga ana tjetër, 24% e deputeteve i kushtojnë mesatarisht 2-3 orë në ditë politikës dhe axhendës politike, në total rreth 19-15 orë në pesë ditët e punës në javë. Kjo ngarkesë është minimale dhe kuptueshme për më tepër kur aktiviteti normal në komisionet dhe në seancat plenare merr së paku 6-10 orë në javë.


Të pyetura se sa orë kalojnë mesatarisht në javë në aktivitete në strukturat partiake, përgjigjet janë më specifike, - mesatarisht 13 orë në javë/2,5 orë në ditët e punës merr angazhimi në aktivitetet partiake, ndërkohë që pjesa tjetër jep përgjigje specifike pa vlerë krahasimore.

3. ANGAZHIMI NË AKTIVITETIN PARLAMENTAR

Angazhimi në aktivitetin parlamentar përbën detyrën, përgjegjësinë dhe aktivitetin kryesor të grave deputete. Parlamenti zhvillon një sërë aktivitete, përfshirë seancat plenare, mbledhjet në komisione, interpelanca, seanca pyetjesh, konsultime, takime të hapura, vizita studimore, komisione ad hoc dhe komisione hetimore, etj. Pjesën më të madhe të punës së tyre deputetët e fokusojnë në axhendën parlamentare. Edhe sistemi i vlerësimit për efikasitetin e tyre bazohet kryesisht në bilancin parlamentar.


3.1. BILANCI I TRAJNIMEVE TË OFRUARA NGA KUVENDI

Rregullorja e Kuvendit detyron institucionin të zhvillojë trajnime të vazhdueshme për deputetët në lidhje me të drejtat, përgjegjësitë, kompetencat, problematikat dhe elementë të tjerë në funksion të cilësisë në përfaqësimin dhe aktivitetin parlamentar. Kuvendi vazhdimisht ka njoftuar zhvillimin e trajnimeve dhe aktiviteteve të tilla, megjithatë të dhënat e anketimeve me gratë deputete tregojnë një situatë tjetër: në total, 35% e grave deputete, shifër pak më e lartë sesa një e treta e parlamentit, deklaron se nuk ka marrë trajnime të nevojshme nga Kuvendi.



Një analizë më e detajuar e të dhënave mund të shpjegohet mbi bazën e dy informacioneve. E para, një numër i madh deputetësh janë prurje të reja gjatë pranverës së vitit 2019 dhe për pasojë, nuk kanë përfituar nga programet e rregullta të trajnimit.

Në lidhje me rastet e trajnimeve të realizuara deputetët u pyetën mbi aspektet konkrete të trajnimeve. Përqindjen më të ulët nga trajnimet e zhvilluara e morën temat që lidhen me procesin e konsultimeve publike (30%), si dhe temat që lidhen me transparencën, llogaridhënien dhe procesin e hartimit të legjislacionit (20%). Tematikat e tjera që lidhen me Rregulloren, Konfliktin e Interesit, marrëdhëniet publike, etj, janë më familjare për deputetët.



Në funksionin parlamentar procesi ligjvënës dhe përfaqësues është aspekti më i rëndësishëm i punës dhe fakti se në këto dy procese niveli i mungesës së trajnimeve është edhe më i madh, shpreh një shqetësim dhe flet për mungesë strategjie efektive nga ana e Kuvendit në drejtim të përmbushjes edhe cilësore të detyrave të tij në raport me trajnimet.


3.2. NEVOJA PËR TRAJNIM DHE ÇËSHTJET PËRKATËSE

Të pyetura mbi nevojat prioritare lidhur me trajnimet gratë deputete renditën problematikën e marrëdhënieve publike dhe praktikën legjislative si më prioritare (31-32%).

Koncepti i marrëdhënieve publike shihet i lidhur edhe me prezantimin në publik përmes debateve në komisione dhe në seancën plenare, me daljet në media dhe në aktivitete publike, etj. Gjatë vitit 2019 ka pasur raste kur fjalime të deputetëve në parlament kanë krijuar headline negative, ndërkohë që pavarësisht nga cilësitë personale, në parlamentet bashkëkohore deputetët kanë stafe ndihmëse dhe marrin trajnime nga parlamenti, grupi parlamentar dhe partia politike për të pasur aftësi prezantimi dhe arritje sa më pozitive në publik dhe në aktivitetin parlamentar.

Tematikë tjetër me mbështetje 60% më të ulët në nevojat për trajnim janë trajnimet mbi konsultimet publike dhe sidomos mbi transparencën dhe llogaridhënien.


Dominimi i nevojës për trajnim në procesin ligjvënës dhe në marrëdhëniet publike në raport me çështjet e llogaridhënies dhe transparencës lidhet edhe me vetë sistemin zgjedhor në Shqipëri, ku deputeti nuk ka zonë specifike dhe ku mungon një kontratë besimi midis tij/saj dhe elektoratit.



3.3. NIVELI I NISMAVE LIGJORE NGA GRATË DEPUTETE

Funksioni i propozimit dhe miratimit të ligjeve / nismave ligjore është funksioni më i rëndësishëm i parlamentit, e drejta e deputetëve për të iniciuar nisma ligjore është një prej privilegjeve kryesore që ata kanë. ISP bën prej vitit 2017 monitorimin e aktivitetit parlamentar dhe vazhdimisht nxjerr statistika edhe mbi nismat ligjore.

Për shkak të vetë sistemit se si funksionon parlamenti në Shqipëri burimi kryesor i nismave ligjore është Këshilli i Ministrave dhe në raste të veçuara edhe grupet parlamentare. Deputetët kanë një rol minor, megjithatë ata mund të jenë aktive në propozimin e ndryshimeve ligjore, sidomos në mbledhjet e komisioneve parlamentare.




Për të verifikuar se sa janë të përfshira deputetët në nismat ligjore dhe amendimet ligjore e përfshimë edhe këtë aspekt në anketim. Në total 58% e grave deputete deklarojnë se në aktivitetin e tyre parlamentar kanë iniciuar amendime ligjore ose nisma të ndryshme ligjore.

Pjesa tjetër që deklaroi se nuk ka bërë nisma ligjore dhe amendime ligjore (42%) është mjaft e lartë, megjithatë duhet lexuar në kontestin e kohës kur është realizuar anketimi. Në atë periudhë një pjesë e deputeteve të përfshira edhe në anketim, ishin në muajt e parë të karrierës së tyre politike në parlament.

3.4. MOTIVET PENGUESE PËR NISMA LIGJORE

Shumë më interesante sesa shifra e nismave ligjore janë faktorët e mundshëm pengues në ushtrimin e funksionit ligjvënës dhe iniciues të akteve ligjore. Të gjitha deputetet deklarojnë se nuk ndjehen nën presionin e frikës në ushtrimin e nismave ligjore dhe ky është lajm pozitiv. Po ashtu janë pozitive përgjigjet 100% se ushtrimi i nismave ligjore nuk është detyrë vetëm e forcës politike që përfaqësojnë deputetet, se për to nuk ka interes publik apo se mungojnë kapacitete ligjvënëse në grup.

E dhënë tjetër interesante është ndarja e qartë e deputeteve 50% vs 50% në vlerësimin mbi mundësinë e miratimit ose jo të nismave ligjore, e dhënë që merr më shumë vlerë nëse merret parasysh fakti se në anketim janë përfshirë më shumë gra deputete nga mazhoranca, sesa nga grupet e opozitës.




Po ashtu dy të dhënat e fundit të tabelës, vlerësimi me dy të tretat i mungesave në stafin legjislativ dhe të ekspertizës personale, janë vlerësime të drejta dhe është një mesazh që vlen për adresim, sidomos tek parlamenti dhe tek drejtuesit e grupeve parlamentare. Kuvendi dhe grupet kanë përgjegjësinë të ofrojnë ekspertizë cilësore për deputetet dhe të ndihmojnë në trajnimin e tyre edhe në aspektin ligjvënës.

3.5. ANGAZHIMI JAVOR NË AKTIVITETIN PARLAMENTAR

Deputetet, sidomos në legjislaturën aktuale, kanë të drejtë por edhe kanë pasur përgjegjësinë nga grupet e tyre, të marrin pjesë në më shumë sesa një komision parlamentar, si dhe në disa komisione ad hoc apo hetimore.

Angazhimi në një numër të madh komisionesh rrit presionin ndaj tyre për më shumë përgatitje, për më shumë kohë në dispozicion të aktivitetit parlamentar, por edhe kufizon mundësinë për investim vetëm në atë fushë ku ato ndjehen më të afta dhe më përfaqësuese.

Deputetet u pyetën për kohën në dispozicion në funksion të angazhimit në komisione dhe në seancat plenare dhe siç rezultoi edhe nga tabela, 89% kanë të përbashkët 3.8 orë në ditë, një shifër e lartë e angazhimit parlamentar. Kjo konstatohet sidomos nëse merret në konsideratë fakti se tradicionalisht Kuvendi operon me 2-3 ditë punë në komisione dhe një ditë në seancën plenare.




Megjithatë nga vlerësimi më i detajuar rezultoi se shkalla e angazhimit lidhet edhe me pozitën e deputeteve në grupet parlamentare dhe në komisionet parlamentare. Aktualisht ka gra deputetë që kanë më shumë se 4-5 përgjegjësi në Kuvend, në grupet parlamentare, në komisionet e përhershme, komisionet e përkohshme, komisionet ad-hoc, si dhe në nën-komisionet. Natyrshëm ato kanë edhe ngarkesë më të madhe kohore dhe aktiviteti parlamentar u merr pjesën më të madhe të angazhimit javor politik.

3.6. RAPORTI MIDIS ANGAZHIMIT POLITIK DHE ATIJ PERSONAL/FAMILJAR

Ekziston paragjykimi se gratë deputete kanë pengesa në karrierën politike edhe për shkak të kohës së kufizuar në ushtrimin e aktivitetit parlamentar si dhe përgjegjësi të shumfishta në jetën familjare, personale dhe profesionale.

Mbi këtë fazë deputetet u pyetën nëse angazhimi parlamentar sjell shqetësime në axhendën familjare dhe personale dhe sesi ato e programojnë aktivitetin e tyre politik në tërësinë e angazhimeve.

Në total një e treta e grave deputete deklaruan se nuk kanë asnjë pengesë për shkak të angazhimit në politikë. Pjesa tjetër e grave, dy të tretat konfirmuan vështirësitë që krijohen, madje 27% konfirmuan angazhimin politik si pengesë. Megjithatë në dy rastet gratë deputete deklaruan se zgjidhjen e kanë gjetur duke bërë planifikimet e duhura (40%) apo duke kërkuar zgjidhje alternative (27%).




3.7. FORMA E KONSULTIMIT TË LIGJEVE NË KUVEND

Në total 65% e deputeteve deklaruan se bëjnë konsultime paraprake me partinë e tyre politike lidhur me qëndrimet ndaj ligjeve në axhendë. Pjesa prej 29% që nuk bën konsultime paraprake i përket kryesisht individëve “të pavarur” në sjelljen politike ose individëve pa lidhje të fortë me ndonjë parti të caktuar politike.

Konsultime me zgjedhësit? Gjysma e grave deputete deklarojnë se bëjnë konsultime, pjesa tjetër ka alternativa të ndryshme. Praktikisht konsultimi me zgjedhësit është shumë i vështirë si nga ana administrative edhe ajo praktike, por mund të realizohet në raste kur në axhendë ka ligje që tërheqin vëmendjen e shoqërisë dhe publikut, pra kanë ndikim direkt tek zgjedhësit ose tek politika ditore në parlament.

Nivelin më të ulët konfirmues e merr alternativa e konsultimeve paraprake me ekspertë të jashtëm për nismat dhe draftet ligjore. Në një mjedis ku mungon ekspertiza institucionale konsultimi me ekspertë të jashtëm mund të ishte zgjidhje optimale, por ky proces varet nga rrethanat, mundësia për njohjen dhe bashkëpunimin me ekspertët e jashtëm, natyra e ligjeve, etj.

Në total 83% e deputeteve shprehen që kanë njohuri të thelluara paraprake mbi përmbajtjen e ligjeve, një shifër shumë e lartë, e cila mund të gjejë shpjegim vetëm nëse me konceptin e njohurive të thelluara nënkuptohen relacionet e komisioneve që shoqërojnë projekt ligjet. Për vetë natyrën parlamentare është e pritshme që deputetët të mos kenë njohuri të thelluara për çdo akt ligjor, por të kërkojnë informacione të mjaftueshme nga grupi parlamentar, kuvendi, komisionet ose grupet e interesit.




3.8. NDJESITË NDAJ FUNKSIONIT, VOTIMIT DHE VENDIMMARRJEVE POLITIKE

Një nga pyetjet më interesante që lidhet me integritetin politik dhe në përfaqësim mori në analizë sjelljen e grave deputete në debatet parlamentare dhe aktivitetin e tyre në raport me standardet parlamentare.

Të dhënat nxjerrin në pah probleme dhe vështirësi në ushtrimin e funksionit parlamentar dhe aktivitetit politik kryesisht për shkak të paragjytimeve, konfliktit politik dhe mungesës së frymës demokratike në partitë politike dhe në vetë politikën shqiptare në tërësi.

Interesant është fakti se përqindjen më të lartë konfirmuese e ka marrë ndjesia e qenies viktimë nga raportimet e medias dhe e lajmet false në portalet online. Në specifikat e paragjykimit mbi bazë gjinore, p.sh, gratë deputete konfirmojnë se janë 13% më pak të respektuara nga kolegët e gjinisë tjetër, sesa nga vetë komuniteti i grave deputete. E dhënë e shpjgueshme me situatën që po kalon vendi është ajo, sipas të cilës, vetëm 41% ndjehen të fuqishme për t'i ndryshuar rrjedhat/gjërat në vend.




Gjetjet më kryesore në formë statistikore janë:

- Mbi 20% pranojnë që kanë votuar ligje për të cilat pasur qëndrime personale kritike,
- Rreth 13% kanë pranuar se kanë deklaruar edhe për gjëra që ato vetë nuk i besojnë
- Shumica, ose 53% deklarojnë se janë ndierë viktimë e medias dhe fake news
- Vetëm 6% deklarojnë se ka pasur mungesë respekti edhe nga koleget gra në parlament
- Rreth 19% deklarojnë se janë ndierë të parespektuara nga kolegët në parlament
- Mbi 47% deklarojnë se janë ndjerë të pafuqishme për të ndryshuar gjërat në vend

- Vetëm 12% vlerësojnë se ndjehen si fasadë në një mjedis të huaj për to
- Një në pesë gra deputete ndjehet e abuzuar për shkak të pamjes ose të veshjes
- Një në katër gra ndjehet e injoruar për shkak të konfliktualitetit dhe klimës politike
- Një në pesë gra ndjehet e censuruar për shkak të mendimit kritik politik
- Mbi 40% e grave deputete ndjehen të akuzuara vetëm për shkak të bindjeve politike
- Mbi 43% e grave deputete ndjehen të denigruara për shkak të mendimeve politike

3.9. NEVOJAT E DEPUTEVEVE PËR TË QENË MË EFEKTIVE NË PARLAMENT

Deputetet u pyetën në pesë alternativa mbi mekanizmin që mund t'i bëjë ajo më efektive në aktivitetin parlamentar. Nga përgjigjet e marra rezultoi se të gjitha deputetet mendojnë se duhen promovuar më shumë gratë dhe të drejtat e tyre në shoqëri, duhet hyrë në debate publike për çështje që ato besojnë dhe mbrojnë, si dhe duhet të njohin e t'i referohen më mirë Kushtetutën dhe legjislacionin në Shqipëri.



Pra, gratë deputete janë në dakordësi për sa i përket nevojës për formim ligjor dhe sjellje ligjore, për mbrojtjen e të drejtave të tyre, për sensibilizim të kauzave gjinore dhe për mbrojtjen e promovimin e parimeve e ideve ku ato besojnë.

Megjithatë, në pyetjen nëse kriter thelbësor për t'u bërë më efektive në politikë është edhe mbajtja e raporteve të afërta me liderin politik dhe partinë, dyfishi e konfirmon, - një tregues i rëndësisë që merr lideri dhe partia në karrierën politike të grave deputete. Në total vetëm një e treta e grave mendojnë se mbështetja e liderit dhe e partisë nuk është thelbësore për të rritur efektivitetin e aktivitetit të tyre parlamentar. Po ashtu, edhe kauza e mbrojtjes së programit politik e partiak është alternativa e dytë më pak e votuar, vetëm 5% që mendojnë ndryshe.

3.10. VLERËSIMI PËR NËNKOMISIONIN MBI BARAZINË GJINORE NË KUVEND

Prej vitesh rritja e kuotave gjinore në kandidim dhe zgjedhje (parlamentare) ka pasur trend rritës dhe është shndërruar në një kauzë lobimi nga vetë gratë deputete, organizatat e tyre, institucione ndërkombëtare dhe shoqëria civile. Pas rritjes së nivelit të përfaqësimit parlamenti vendosi të krijojë edhe një nënkomision për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj grave. Ngritja e kësaj strukture u konsiderua sukses dhe produkt i rritjes së kuotës gjinore në përfaqësim.

Për të parë realisht perceptimin mbi efektet e këtij nënkomisioni gratë deputete u pyetën mbi vlerësimin ndaj tij. Në total 67% e grave deputete vlerësojnë se nënkomisioni nuk ka kapacitete këshillimore dhe as buxhet specifik për aktivitete, duke e konsideruar këtë si cilësinë e tij më kritike.










Më pas, në vlerësimet negative futen katër përcaktime të tjera, si p.sh, 56% mendojnë se nënkomisioni nuk asistohet sa duhet nga Kuvendi dhe as nga grupet parlamentare, 50% mendojnë se nuk kjo


strukturë nuk ka marrë në shqyrtim as ligjet e aktet parlamentare që lidhen me gratë, si dhe po 50% mendojnë se vetë nënkomisioni nuk ia ka dalë ende të ofrojë politika imponuese apo korrigjuese mbi ato që ndjek pushteti ekzekutiv.

Në dy tregues gratë deputete nuk pajtohen me përcaktimet e ofruara nga anketimi. Për shembull dy të tretat e grave deputete nuk ndajnë të njëjtin opinion se nënkomisioni nuk reflekton barazinë gjinore për shkak se 78% përbëhet nga gra deputete dhe vetëm 22% zë gjinia tjetër. Gjithashtu deputetet nuk janë në tërësi dakord me kritikën e ashpër se ky nënkomision nuk ka impakt në forcimin e mjedisit të përfaqësimit gjinor.

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas


Kompetencat
Programi i Punës
Përbërja
Rendi i ditës
Veprimtaria
Procesverbale

			
ANTONETA DHIMA ✉ Kontakto	EGLANTINA GJERMENI ✉ Kontakto	ELONA HOXHA ✉ Kontakto	KLODIANA SPAHIU ✉ Kontakto
			
MUSA ULQINI ✉ Kontakto	RUDINA HAJDARI ✉ Kontakto	ARLIND ÇAÇANI ✉ Kontakto	EDIOLA BRAHA ✉ Kontakto
			



3.11. GRATË DEPUTETE DHE DISKRIMINIMI NDAJ TYRE NË KUVEND

Deputetet u pyetën nëse janë ndjerë të diskriminuara për shkak të gjinisë në parlament, gjatë aktivitetit dhe ushtrimit të funksionit, në debatet parlamentare apo në praktikatat e tjera të punës në Kuvend.




Në total 63% e grave deputete deklarojnë se nuk kanë pasur raste diskriminimi për shkak të gjinisë në parlament dhe se ndjehen të barabarta me kolegët e tjerë të kuvendit. E dhëna kritike e kësaj pyetje lidhet me pjesën e grave deputete që konfirmojnë se janë ndjerë rregullisht të diskriminuara për shkak të gjinisë.

Në total janë 16% e grave të pyetura, ose një në gjashtë gra deputete. Përqindja duket statistikisht e vogël, por ekzistenca e diskriminimit për shkak të gjinisë në Kuvend dhe aktivitetin parlamentar është një tregues vërtetë kritik dhe shqetësues. Këtij shqetësimi i bashkohet edhe pjesa tjetër prej 21% e grave deputete, të cilat ndjehen pjesërisht të diskriminuara në aktivitetin parlamentar.

3.12. MBËSHTETJA E PARTIVE ME KONSULTIME/ASISTENCË NDAJ GRAVE DEPUTETE


Vetëm 43% e grave deputete konfirmojnë se partitë e tyre politike bëjnë konsultime mbështetëse për gratë deputete për t'u mundësuar atyre të luajnë rol të barabartë në aktivitetin parlamentar dhe në vendimmarrjen politike. Kjo përqindje vlen vetëm për gratë që pranojnë se janë pjesë e partive politike, ndërkohë që 14% nuk janë anëtare partie, kryesisht gra të ardhura në parlament gjatë sesionit të parë të vitit 2019.



Nga ana tjetër vetëm 11% e grave deputete deklarojnë se kanë barazi të plotë në parti e në parlament dhe për rrjedhojë nuk kanë nevojë për investim të partisë së tyre politike në funksion të barazisë në aktivitete dhe në përfaqësim. Shifra është e njëjtë me përqindjen e grave deputete, të cilat deklarojnë se në partitë e tyre politike nuk ka konsultime dhe as mbështetje për nisma të tilla. Po ashtu, një në pesë gra në parlament deklarojnë qëndrime kritike për partitë e tyre politike, duke thënë se ato nuk bëjnë konsultime dhe as nuk japin mbështetje sa duhet për të pasur barazi në përfaqësim dhe në aktivitetet vendimmarrëse parlamentare dhe partiake.

3.13. LEGJISLACION PËR RRRITJEN E PËRFAQËSIMIT GJINOR?

Realizimi i rritjes së përfaqësimit gjinor nuk arrihet vetëm përmes legjislacionit zgjedhor të kuotave në kandidim, por edhe përmes elementëve të tjerë të legjislacionit që mundësojnë p.sh, jo vetëm kuota kandidimi, por edhe kuota zgjedhore gjinore. Mbi këtë bazë gratë deputete u pyetën nëse ato janë në gjendje të ndërmarrin nisma ligjore, të cilat mund të rrisin përfaqësimin gjinor në politikë.




Nga përgjigjet e dhëna rezulton se ka një konsensus të gjerë me rreth 84% se gratë deputete janë në gjendje të bëjnë promovime të rritjes së përfaqësimit gjinor përmes nismave ligjore. Pjesa mosbesuese ndaj aftësisë dhe mundësisë për nisma ligjore zë vetëm 6%, ndërkohë që 10% e deputeteve deklarojnë se nuk e shohin zgjidhjen tek rritja e sistemit të kuotave kandiduese / zgjedhore, por tek koncepti i barazisë për të gjithë gjinitë në konkurrim.

Ky përgjigje tregon për një potencial të madh të grave deputete në të gjitha grupet politike për të ndjekur politika e ndërmarrë nisma konsensuale në favor të rritjes së përfaqësimit gjinor në politikë. Gjithashtu përgjigjet tregojnë se ende shumica e grave deputete, me të drejtë, besojnë se kuotat gjinore janë zgjidhja e duhur afatshkurtër për të arritur tek përfaqësimi natyral i barabartë i gjinive në politikë, sidomos në jetën parlamentare.

3.14. RAPORTI I GRAVE DEPUTETE ME FORUMET E GRAVE NË PARTITË POLITIKE

Të dhënat mbi nivelin e angazhimit të grave deputete në forumet ose organizatat partiake të grave tregojnë se rreth dy të tretat janë pjesë e këtyre forumeve. E dhënë tjetër interesante është deklarimi i 11% të grave deputete se në forcat politike të tyre nuk ka forum dhe as organizate të grave. Pjesa tjetër prej 24% është pak ose mesatarisht e angazhuar në forumet e organizatat e grave në partitë politike.


Fakti se midis grave të përfshira në anketim nuk ka pothuajse asnjë përgjigje që konfirmon se gratë nuk kanë angazhim në forumet/organizatat e grave në partitë e tyre politike është tregues se prurjet nga shoqëria civile apo emrat jashtë politikës *de facto* janë prurje dhe emra që vijnë nga një eksperiencë e rol në politikën e strukturat gjinore brenda partive politike. Gjithashtu të dhënat e tabelës janë tregues se ekzistenca e forumeve/organizatave në partitë politike është domosdoshmëri, është standard organizimi dhe një instrument me rëndësi në promovimin e grave në politikë.



3.15. RAPORTI ME ALEANCËN E GRAVE DEPUTETE

Aleanca e Grave Deputete (AGD) është organizim i ri dhe përpjekje për të krijuar një përfaqësim mbipartiak i të gjitha grave deputete, lobuese në çështje të përbashkëta dhe aktive në promovimin e kauzave dhe problematikave që kanë sfond gjinor. Krijimi i saj ndonëse i vonuar është e mbetet zhvillim pozitiv.

Në dy legjislaturat e fundit drejtimi i AGD i është besuar me konsensus një përfaqësuese politike nga që vjen nga opozita, kurse përfaqësuesja e mazhorancës mban vendin e dytë më të rëndësishëm drejtues. Edhe në legjislaturën aktuale është i njëjti raport përfaqësimi pavarësisht diferencave në numra midis deputetëve të mazhorancës dhe të opozitës.



Për shkak të rëndësisë dhe mundësive që ofron në përfaqësimin e problematikave gjinore dhe të vetë potencialeve të grave në politikë u përfshinë në anketim disa pyetje me objekt AGD.


Konkretisht deputetet u pyetën nëse janë aktive brenda Aleancës, duke marrë si përgjigje konfirmimin se 81% e tyre janë pjesë përbërëse e Aleancës. Në pjesën tjetër që përbën 19% bëjnë pjesë kryesisht ish-deputete në parlament që dorëzuan mandatet gjatë fillimit të vitit 2019, por gjithashtu ka pasur së paku tri raste kur deputetet aktuale kanë deklaruar se nuk janë pjesë aktive e Aleancës.

3.16. AGD DEPUTETE SI INSTRUMENT PROMOVIMI PËR GRATË POLITIKANE?


Deputetet u pyetën nëse AGD është e angazhuar në promovimin e grave deputete apo në çështjet gjinore. Vetëm një në pesë gra konfirmon se Aleanca bën promovimin e grave deputete dhe çështjeve gjinore, ndërkohë që pothuajse gjysma e grave deputete deklarojnë se AGD nuk i përmbush këto dy pritshmëri.

Pjesa e grave deputete që sheh vetëm rezultate modeste të AGD është 15%, kurse 12% ofrojnë përgjigje të tjera alternative. Interesant është fakti se 8% e grave të përfshira në anketim deklarojnë se nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi përmbushjen e këtyre dy funksioneve nga AGD prandaj preferojnë të mos japin një opinion kritik apo mbështetës.

Më tej, vetëm deputetet që janë aktive në AGD u pyetën mbi sfidën kryesore të këtij grupimi, çfarë ajo duhet të bëjë në dallim nga nënkomisioni parlamentar për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas. Kjo pyetje ishte shumë më e rëndësishme, sesa përkatësia dhe niveli i angazhimit në AGD. Të dhënat e dala nga përgjigjet janë interesante dhe mund të përbëjnë një program pune për të ardhmen e vetë Aleancës.



Konkretisht, kategoria më e votuar e sfidave të ardhshme nga gratë deputete është nevoja që ajo të mbetet konsensuale dhe mbipartiake, pra e pandikuar nga raportet apo konfliktet politike në parlament. Përqindja e lartë në këtë sfidë është tregues i rritjes së maturimit të grave deputete dhe e ndërgjegjësimit mbi nevojën që çështje me interes të përbashkët të shihen e trajtohen mbi linjat dhe interesat partiake të palëve në parlament.




Sfida e dytë kryesore për AGD është nevoja për të ndërmarrë nisma ligjore promovuese për përfaqësimin e grave në politikë dhe mbrojtjen e këtij përfaqësimi. Fakti se një në pesë deputetet e konsideron këtë sfidë si prioritarë është tregues i besimit se vetëm përmes nismave ligjore konsensuale mund të ketë përfaqësim të qëndrueshëm gjinor në partitë politike dhe në legjislaturat e ardhshme parlamentare.

Sfida e tretë është nevoja që AGD të asistojnë gratë deputete në aktivitetin e tyre parlamentar dhe të mbështetëse publikisht gratë në politikë. Koncepti i asistimit dhe mbështetjes është pozitiv, por *de facto* është i lidhur me statusin dhe kapacitetet e vetë AGD për të ofruar një shërbim të tillë, në çështje që nuk kanë të bëjnë me linjat partiake të debatit apo të votimit.

Dy sfidat e tjera më pak prioritarë janë promovimi i përhershëm i grave deputete dhe sidomos marrja e tyre në mbrojtje nga sulmet që iu bëhen në aktivitetin politik. Kjo e fundit është gjetje interesante që vjen në kontrast me përvoja të legjislaturës së kaluar kur komuniteti i grave ka qenë nën presion për të marrë apriori në mbrojtje gratë deputete apo politikane nga sulmet që i'u bëhen në aktivitetin e tyre vendimmarrës.

3.17. REKOMANDIME E SFIDA PËR ALEANCËN E GRAVE DEPUTETE

Pasi gratë deputete dëshmuar mbi lidhjen me partitë e tyre, me organizatat e grave në parti, përkatësinë dhe aktivitetin në kuadër të Aleancës së Grave Deputete dhe sfidat e saj kryesore politike, anketimi i ftoi ato të shprehen edhe për çështje konkrete që duhen përmirësuar në vetë staturën e AGD.



Konkretisht, një në pesë gra deputete sugjeruan që AGD duhet të jetë shumë më tepër aktive në aktivitetin e rolin e saj publik dhe në parlament. Po ashtu, 17% e grave mendojnë se AGD duhet të promovojë më shumë gratë politike e deputete në secilën prej partive politike, shifër e njëjtë edhe me sugjerimin që Aleanca duhet të ketë mbështetje financiare për të mundësuar aktivitetet e saj.

Në total tri kategori të tjera kanë të njëjtin vlerësim, 13%. Ato janë kategoria që sugjerojnë rritjen e kompetencave të Aleancës, nevoja për reformimin e saj, si dhe kundërta, mbajtja e të njëjtës staturë, pa kompetenca të tjera shtesë. Kategoria më pak e kuotuar është ajo e ndjekjes prej Aleancës të modeleve pozitive të vendeve të tjera, kategori e cila siç duket mund të lidhet edhe me faktin se një pjesë e grave deputete nuk kanë njohuri të thelluara mbi modelet pozitive të vendeve të tjera.


4. LIDHJA ME ZONËN, ZGJEDHËSIT DHE PUBLIKUN

Deputetët përfaqësojnë zgjedhësit dhe zgjidhen sipas sistemit proporcional me lista të mbyllura. Legjitimiteti i deputetëve nuk bazohet vetëm në mandatin kushtetues, por edhe në përfaqësimin e qytetarëve në vendimmarrjen politike. Në aktivitetin e tyre deputetët fokusohen kryesisht në zonat ku janë zgjedhur/caktuar nga partitë politike. Lidhja me zgjedhësit i ndihmon ata të jenë më përfaqësues, gjithashtu të jenë edhe vetë në monitorim në një proces llogaridhënie që vijon gjatë gjithë mandatit parlamentar. Për shkak të rëndësisë që merr lidhja e deputetëve me zonat zgjedhore, zgjedhësit dhe qytetarët një pjesë e rëndësishme e anketimit iu kushtua kësaj problematike.

4.1. PËRFAQËSIMI NË ZONË? PREFERENCA DHE DELEGIMI NGA PARTIA

Deputetët u pyetën në lidhje me zonat që ato përfaqësojnë aktualisht në parlamentin shqiptar. Të dhënat e përfaqësimit janë të dyfishta: zonat që ata ndejnë se përfaqësojnë dhe zonat ku partitë i kanë deleguar të përfaqësojnë. Një e pesta e deputeteve pranuan se kanë ndryshuar zonën elektorale nga zgjedhjet 2017 për shkak të vendimit politik të partisë, megjithatë katër në pesë gra deputete vijonin të ishin aktive ende në zonën ku konkurruan në zgjedhjet e fundit.

Në total, 15% e grave deputete deklaruan se nuk përfaqësojnë zonë të veçantë, kryesisht deputetet e ardhura me 2019 në parlament ose disa deputete të tjera që vazhdimisht kanë qenë në lëvizje nga zona në zona në varësi nga vendimi politik i partisë së tyre.




Të dhënat e tabelës tregojnë se 38% e grave në anketim janë të fokusuar në qarkun e Tiranës, kategoria e dytë më e madhe në përfaqësim janë qarqet Durrës dhe Elbasan (12%), për të vijuar më pas me qarqet e tjera. Asnjë nga deputetet nuk ishte përfaqësuese e qarkut Kukës.

Të dhënat nuk kanë ndonjë vlerë përmbajtësore, por statistikore, sepse bëjnë dallim nga votat dhe rezultatet e dala në zgjedhjet parlamentare 2017. Për shembull, qarku Kukës në ato zgjedhje nxori një grua deputete nga mazhoranca, por pas zgjedhjeve kanë ndryshuar zonat elektorale në kuadër të organizimit të brendshëm politik.

4.2. ZGJEDHJE APO EMËRIM NË ZONËN ELEKTORALE?

Diferenca midis preferencës personale në zonë dhe vendimit politik shfaqet më qartë në pyetjen vijuese mbi mënyrën sesi gratë deputete e kanë zgjedhur zonën e tyre elektorale në 2017. Nga përgjigjet e dhëna rezulton se në 63% të rasteve zona është caktuar nga forca e tyre politike, në vetëm 16% të rasteve gratë deputete kanë pasur të drejtë të zgjedhin zonën ku do të kandidonin.

Në pyetjen tjetër nëse zgjedhja e tyre ka qenë përcaktim nga partia apo propozim nga baza e anëtarësisë, 21% ose një në pesë gra deputete deklaror se ka qenë propozim i bazës së partisë. Kjo përqindje, ndonëse numerikisht duket e vogël, në thelb shpreh trendin se elektorati ka preferenca ndaj përfaqësimit të miksuar gjinor dhe nisja nga 21% e parlamentit është tregues i mirë për një sistem promovimi që bazohet kryesisht tek vendimmarrja piramidale në partitë politike.




4.3. TRI SHQETËSIMET KRYESORE PËR VOTUESIT MESHKUJ – FEMRA

Për të hyrë në problematika konkrete të zonës elektorale gratë deputete u pyetën se cilat ishin tri nga shqetësimet kryesore për gratë e vajzat e zonës së tyre elektorale. Përgjigjet e dhëna ofrojnë larmi problematikash. Midis tyre rezultojnë si më prioritare niveli i lartë i papunësisë (19%), kuotë e distancuar nga prioritetet e tjera.

Në nivele të njëjta (13.16%) identifikohen dy shqetësime, - problemet me punësimin e të rinjve dhe niveli i shkollimit të mangët. Janë dy probleme, të cilat përbëjnë bazën sociale të një të majte, e cila është aktualisht në mazhorancë në dy zgjedhjet e fundit parlamentare. Prioriteti i tretë për gratë dhe vajzat e zonave zgjedhore të grave deputete janë nevoja për një sistem më efikas të kujdesit ndaj fëmijës, problemet e emigrimit, problemet në bujqësi e mjedis, si dhe në kuotë të njëjtë me to edhe nevoja për barazi të plotë gjinore. Në prioritetet më pak të kuotuar janë konfliktualiteti i lartë politik në vend (2%), mungesa e qartësisë për integrim dhe aksesit i kufizuar në drejtësi (3.9%), korrupsioni i lartë (5.2%) dhe kujdesi shëndetësor i pjesshëm (6.58%).


Të njëjtat pyetje u fokusuan edhe për pjesën tjetër të elektoratit, votuesit meshkuj. Tek kjo kategori dy shqetësimet që lidhen me papunësinë, - papunësia tek të rinjtë dhe papunësia e lartë në tërësi kanë kuota maksimale me 43.8%, ndaj rreth 33% tek vajzat dhe gratë.



Problematika e tretë është e njëjtë në dy rastet, shkollimi i mangët, i ndjekur gjithashtu nga problemet e krijuara nga valët e emigrimit nga Shqipëria në drejtim të vendeve perëndimore. Problemet me mjedisin dhe bujqësinë kanë gjithashtu kuotë të lartë tek gjinia mashkullore. Është interesante analiza e tabelës së përgjigjeve nga përgjigjet fundore, - asnjë nga përgjigjet nuk ka votuar si shqetësim çështjet e nevojës për barazi gjinore apo të kujdesit ndaj fëmijës, duke i marrë këto të mirëqena vetëm për vajzat dhe gratë banore të zonës zgjedhore. Korrupsioni i lartë gjithashtu ka kuota të ulta si shqetësim prioritar, pavarësisht se papunësia e lartë ekziston në vende me korrupsion të lartë.

4.4. FTESA DHE TAKIME NË AKTIVITETET PUBLIKE

Lidhur me ushtrimin e kompetencave parlamentare, komunikimin publik dhe politik, marrëdhëniet publike me elektoratin dhe median, përgjigjet e ofruara nga gratë deputete kanë vlerë të dyfishtë, - sepse tregojnë jo vetëm nivelin aktual të komunikimit, por edhe trendin e komunikimit në tërësi të politikanëve me qytetarët zgjedhës. Një prej të drejtave të deputetëve është marrja çdo muaj e ftesës dhe e draft axhendës së mbledhjeve dhe aktiviteteve të pushtetit vendor, e drejtë e cila nuk është aplikuar në standardin e kërkuar. Anketimi e provon këtë vlerësim kritik. Në total 13% e grave deputete deklarojnë se nuk janë ftuar asnjëherë në mbledhjet dhe aktivitetet e bashkive në zonën e tyre zgjedhore. Kategoria më e kuotuar është pjesëmarrja/ftesa në së paku 5 raste në muaj, shifër që përmbledh çdo lloj ftese dhe çdo lloj aktiviteti të organizuar nga bashkitë lokale.




Në pyetjen se sa herë në muaj gratë deputete ftohen nga media për emisione ose debate televizive, 53% deklarojnë se ftohen 5 herë në muaj, shifër mjaft e lartë dhe një akses me shumë rëndësi në promovimin e aktivitetit të grave deputete. Kjo shifër e dhënë nga deputetet vjen në kontrast të thellë me raporte të mëparshme të ISP, sipas të cilave vetëm një numër minimal i grave deputete ka qenë pjesëmarrëse dhe aktive në debatet publike dhe mediatike.

Gjithashtu, nga të dhënat rezultoi se ftesat më të shumta mujore gratë deputete i marrin nga organizata dhe institucione ndërkombëtare në Shqipëri, - një tregues i rëndësisë që këto të fundit i kushtojnë aktivitetit të tyre dhe rritjes së cilësisë dhe peshës së përfaqësimit gjinor në parlament dhe në politikë. Në total 80% deklarohen se marrin deri në 5 ftesa në muaj prej tyre. Edhe në matjen e bilancit të takimeve me elektoratin, për shumicën e grave të përgjigjura në 80% të rasteve zhvillohen deri në 5 takime mujore.

4.5. FAKTORË PENGUES PËR LIDHJE TË FORTË ME ZONËN ELEKTORALE

Në vijim gratë deputete u pyetën për rëndësinë e disa prej treguesve politikë dhe administrativë në raport me lidhjen më të fortë të tyre me zonën elektorale. Konkretisht, 94% e grave deputete mendojnë se është e vështirë të përmbushet misioni i tyre përfaqësues për zonën kur ato përfaqësojnë një zonë me nivel të lartë varfërie.




Me 88% shprehen se është i vështirë përfaqësimi kur pushteti lokal në zonën elektorale drejtohet nga partia rivale politike. I njëjti numër i grave deputete (69%) vlerëson se lidhja me zonën elektorale është më e vështirë kur nuk ka asnjë ministër vendimmarrës nga ajo zonë, kur në zonë nuk ka media lokale dhe kur zona dominohet nga njësi vendore rurale. Në fund, 65% shprehen se është më e vështirë aktiviteti në zonën elektorale për gratë deputete, sesa për burrat deputetë.

4.6. TË DISKRIMINUARA NË FUSHATË?


Deputetet u pyetën nëse në fushatën elektorale, janë ndjerë të diskriminuara në burime financiare e teknike për fushatë, në retorikën ndaj tyre apo në kapacitetet mbështetëse për një fushatë të suksesshme. Mbi gjysma e grave deputete deklarojnë qartësisht se janë ndierë të diskriminuara, sidomos në burimet financiare dhe retorikën ndaj tyre.

Për shkak të sistemit elektorale kandidatët për deputetë dhe më pas edhe deputetët (pas zgjedhjes) nuk kanë buxhete aktivitetsh në dispozicion dhe se çdo vendimmarrje mbështetëse ose jo, varet nga forca politike mbështetëse. Edhe në kapacitetet mbështetëse për fushatë të suksesshme ka kritika nga deputetet gra, megjithatë për shkak të fushatës elektorale jo mazhoritare, kapacitetet mbështetëse bazohen kryesisht tek lideri politik dhe partia politike dhe shumë më pak tek dega lokale apo stafi i kandidatit për deputet.

Nga përgjigjet e dhëna 27% deklarojnë se nuk janë ndjerë të diskriminuara në asnjërin prej tre treguesve: burimet financiare, burimet mbështetëse dhe retorikën ndaj tyre nga rivalët politikë. Kjo është një përqindje e lartë për një vend me konfliktualitet të ashpër politik dhe pa burime proporcionale financiare për kandidatët dhe zonat për deputetë. Pjesa tjetër e deputeteve kanë mendim të ndërmjetëm, mungesa në një prej elementëve dhe mbështetje në elementin tjetër.




Deputetet u pyetën nëse kanë ndeshur ndonjë vështirësi specifike në kandidimin për poste politike apo në ushtrimin e detyrës së tyre si deputete në Kuvend për shkak të gjinisë. Dy të tretat e tyre deklaruan se nuk i kanë ndeshur këto vështirësi. Ky është një lajm i mirë dhe një tregues i progresit në klimën politike konkurruese partiake dhe në aktivitetin parlamentar. Megjithatë merr vlerë të veçantë përgjigjia e 22% të grave deputete, të cilat pranojnë se kanë ndeshur në vështirësi, pengesa dhe paragjykime për shkak të gjinisë.



Në shifra krahasimore do të thotë se një në sërë paku pesë deputete paragjykohe për shkak të gjinisë në kandidimin për poste politike ose në ushtrimin e aktivitetit parlamentar. Shifra është e lartë, pavarësisht natyrës së vështirësive specifike të dhënë. Nga ana tjetër 11% kanë vlerësime të ndërmjetme, duke interpretuar rrethana dhe situata të caktuara, gjatë të cilave ato mendojnë se mund të kenë ndjerë vështirësi të pjesshme ose paragjykime specifike në ushtrimin e aktivitetit parlamentar apo në jetën politike.

Gratë deputete nuk u pyetën specifikisht për të dhënë situata konkrete të vështirësive, për shkak të numrit të vogël të grave deputete në anketim dhe vështirësisë për të gjetur kategorizime të përbashkëta vlerësuese. Megjithatë 22% e grave deputete që pranuan problematikat dhe 11% që ka qëndrime të ndërmjetme, u pyetën në mënyrë më të thelluar se si ato i kanë përballuar vështirësi të tilla.

Përgjigjet e dhëna janë interesante: 19% e grave deputete deklaruan se e kanë zgjidhur situatën e vështirë të krijuar, duke iu shmangur konfliktit ose duke u tërhequr. Pjesa më e madhe e grave deputete deklarojnë se e kanë zgjidhur problematikën e krijuar përmes angazhimit të kujdesshëm dhe trajtimit me durim të çështjes/situatës, (38%).



Me komunikim direkt, sidomos në rastet e fushatave elektorale apo garës në parti, kanë gjetur zgjidhje vështirësitë e krijuara 19% të grave deputete, ndërkohë që 13% deklarojnë se e kanë zgjidhur çështjen/situatën përmes investimit personal pa mbështetjen e partisë ose grupit, ose me formë tjetër.

4.7. METODAT MË EFEKTIVE PËR KOMUNIKIM ME ELEKTORATIN

Gratë deputete u pyetën mbi format e preferuara të komunikimit publik me elektoratin gjatë aktivitetit të tyre.

Vlerësimin më të lartë e mori praktika e kontakteve direkte me elektoratin 100%, vlerësimi i dytë më prioritar ishte ai i komunikimit me telefon (56%), vlerësimi i tretë përmes medieve sociale (50%), vlerësimi i katërt përmes medias (50%), vlerësimi i pestë përmes strukturave partiake (50%), vlerësimi i gjashtë përmes stafit mbështetës (38%), vlerësimi i shtatë përmes e-mailit (31%) dhe vlerësimi i tetë, pra i fundit në listën e vlerësimeve prioritare ishte përmes shërbimit postar (56%).

FORMA MË E MIRË E KOMUNIKIMIT	Shërbimi postar	Takime direkte	Me telefon	Me e-mail	Rrjete sociale	Përmes medias	Përmes partisë	Përmes stafit
Vlerësimi 1	13%	100%	6%	6%	13%	6%	6%	6%
Vlerësimi 2	6%	0%	56%	0%	13%	0%	13%	0%
Vlerësimi 3	0%	0%	6%	19%	50%	6%	13%	0%
Vlerësimi 4	0%	0%	6%	6%	13%	50%	6%	13%
Vlerësimi 5	0%	0%	0%	0%	6%	13%	50%	38%
Vlerësimi 6	0%	0%	19%	13%	0%	19%	6%	25%
Vlerësimi 7	25%	0%	6%	31%	6%	6%	6%	6%
Vlerësimi 8	56%	0%	0%	25%	0%	0%	0%	13%
TOTAL	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Duke u përqendruar tek vlerësimi i parë prioritar rezulton se 56% janë kundër formës së shërbimit postar, 100% janë për takime direkte, 56% janë për komunikim me telefon, vetëm 31% janë për komunikim prioritar me e-mail, 50% u besojnë rrjeteve sociale si formë komunikimi, 50% i besojnë gjithashtu medias si formë komunikimi efektiv, 50% i besojnë organizimit partiak dhe 38% i besojnë komunikimit përmes stafit.

Rezultatet tregojnë se format tradicionale (takime direkte, partia dhe stafi) janë ende si forma që besohet se sjellin efektivitet, ndërkohë që praktikisht ato janë shumë më me kosto dhe më të vështira për t'u realizuar gjatë mandatit katër vjeçar. Format e reja të komunikimit, sidomos ai përmes rrjeteve sociale, medias dhe e-mailit kanë gati dyfish më pak mbështetje, sesa komunikimet direkte me elektoratin.

4.8. LOGJISTIKA MBËSHTETËSE DHE MJETET E KOMUNIKIMIT PUBLIK

Elementët e logjistikës në mundësimin e aktivitetit parlamentar për deputetet, si dhe elementët që deputetet përdorin për komunikimin politik e publik, kanë rëndësi për të vendosur përballë pritshmëritë publike dhe mjeteve në dispozicion për përmbushjen e tyre, si dhe raportet e vetë deputetëve me zhvillimet teknologjike në format e komunikimit publik e politik.

Nga të dhënat e tabelës rezulton se:

- 100% e grave deputete deklaruan se nuk kanë financim të mjaftueshëm për aktivitetet
- 100% deklaruan se kanë adresë e-mail-i përmes të cilës mund të kontaktohen
- 94% deklaruan se kanë profile zyrtare dhe personale në rrjetin social facebook
- 88% deklaruan se kanë profile personale në rrjetin social instagram
- 87% deklaruan se nuk kanë sponsorizimeve nga mbështetësit e partisë politike
- 84% deklaruan se kanë një adresë të tyre publike ku elektorati mund t'i kontaktojë
- 65% deklaruan se kanë zyra elektorale për takime me zgjedhësit, mjedise që janë siguruar ose nga parlamenti (zyrat në qarqe) ose përmes linjës partiake.
- 63% deklaruan se nuk kanë këshilltarë për asistimin e aktivitetit të tyre
- 56% deklaruan se nuk kanë staf të mjaftueshëm mbështetës nga partia e tyre politike
- 56% deklaruan se kanë zyrë në Kuvend për aktivitete dhe takime me elektoratin
- 50% deklaruan se kanë dhe po kaq nuk kanë adresa në rrjetin social twitter

NË FUNKSIONIN E DEPUTETES SË KUVENDIT, A KENI?	PO	JO	TJETËR
Zyrë elektorale për aktivitet dhe takime	65%	35%	0%
Zyrë në Kuvend për aktivitet dhe takime	56%	44%	0%
Këshilltarë ndihmës që ju asistojnë	38%	63%	0%
Financim të mjaftueshëm për aktivitetin tuaj	0%	100%	0%
Staf mbështetës nga partia juaj	38%	56%	6%
Sponsorime nga mbështetës të partisë tuaj	13%	87%	0%
Adresë publike për t'ju kontaktuar	94%	6%	0%
E-mail zyrtar për t'ju kontaktuar	100%	0%	0%
Profil zyrtar për komunikim në Facebook?	94%	6%	0%
Profil zyrtar për komunikim në Instagram?	88%	13%	0%
Profil zyrtar për komunikim në Twitter?	50%	50%	0%

4.9. PIKËPAMJET E GRAVE MBI DISA PËRCEPTIME PUBLIKE RRETH TYRE

Në funksion të plotësimin të profilit prezantues, të nivelit përfaqësues dhe të identitetit politik të grave deputete, u përfshinë në anketim edhe një sërë pyetjesh që lidhen me perceptime publike ndaj grave në politikë, në vendimmarrje dhe në jetën publike. Disa prej pyetjeve janë të përsëritura indirekt nga pyetje që janë dhënë më parë në formë tjetër, me idenë për të marrë një përgjigje më direkte që konfirmon ose jo thëniet e mëparshme gjatë anketimit.

A JENI DAKORD ME PERCEPTIMET PUBLIKE SE:	PO	JO	TJETËR
Gratë janë menaxhere politike më të afta, sesa burrat	65%	29%	6%
Gratë në politikë duhet të sakrifikojnë për karrierën	63%	38%	0%
Gratë në politikë janë më shumë produkt kuotash, sesa meritash	29%	65%	6%
Gratë në politikë kanë sjellë ndryshime pozitive për vendin	94%	6%	0%
Gratë në politikë janë më pak të korruptuara, sesa burrat	82%	18%	0%
Gratë ministre janë më të afta se burrat ministra	24%	65%	12%
Gratë drejtuese në komisione janë më të afta se burrat drejtues	24%	65%	12%
Gratë në parlament flasin më profesionalisht se burrat deputetë	50%	50%	0%
Gratë në politikë janë më pak të inkriminuara se burrat	94%	6%	0%
Gratë me fëmijë kanë kufizime në ushtrimin e politikës	35%	59%	6%
Gratë deputete duhet të caktohen vetëm në zonat urbane	0%	88%	12%
Mjedisi politik në Shqipëri është pengues për gratë në karrierë	59%	41%	0%
Mjedisi publik në Shqipëri është paragjykes për gratë në karrierë	76%	24%	0%
Media në Shqipëri është spekuluese për gratë në karrierë	67%	27%	7%

Përgjigjet janë mjaft interesante dhe tregojnë se gratë deputete janë shumë më imune ndaj korrupsionit dhe inkriminimit, si dhe kanë vlerësim më të lartë për punën e tyre, sesa gjinia për politikanët e tjerë. E vetmja pikë ku gratë ndajnë pikëpamje të njëjtë me burrat deputete është cilësia e fjalimeve dhe debateve në parlament.

Nga të dhënat e nxjerra prej tabelës krahasuese rezultojnë se:

- 94% mendojnë se gratë politike janë më pak të inkriminuara, sesa burrat
- 94% mendojnë se gratë në politikë kanë sjellë ndryshime pozitive për vendin
- 88% mendojnë se gratë deputetë caktohen vetëm në zona urbane
- 82% mendojnë se gratë politike janë më pak të korruptuara, sesa burrat politikanë
- 67% mendojnë se media në vend është spekuluese ndaj grave në karrierë
- 65% janë kritike ndaj vlerësimit se ato janë më shumë produkt kuotash, sesa meritash
- 65% mendojnë se gratë drejtuese në komisionet në Kuvend janë më të afta, sesa burrat
- 65% mendojnë se gratë menaxhere politike janë më të afta, sesa burrat
- 63% mendojnë se gratë në politikë duhet të bëjnë sakrificë për karrierën
- 59% mendojnë se gratë me fëmijë kanë kufizime në ushtrimin e aktivitetit politik
- 59% mendojnë se mjedisi politik është paragjykes për gratë në karrierë
- 50% mendojnë se gratë flasin më profesionalisht në parlament, po aq sa edhe gjinia tjetër

4.10. ÇFARË DUHET NDRYSHUAR? LOBIMI, KUOTAT DHE PRURJET NË POLITIKË

Një set tjetër pyetjesh iu adresua sugjerimeve për ndërhyrje përmirësuese në të ardhmen në reformën zgjedhore, në lobimin për rritjen e përfaqësimit gjinor dhe për elementë të tjerë që lidhen me sensibilizimin, përfaqësimin dhe mirë-funksionimin.

Nga të dhënat e ofruara në përgjigje konfirmohen një pjesë e madhe e përgjigjeve të dhëna më parë në forma më indirekte, por edhe jepen opinione të rëndësishme që vijnë shpesh edhe në kontrast me zhvillimet reale në politikë. Për shembull, 100% mendojnë se duhen forcuar organizatat e grave brenda partive politike, por PS, nga e cila vijnë shumica e grave deputete, ndryshoi qëndrim ndaj forumit të gruas dhe kryeministri deklaroi gjatë 2019 se nuk ishte i nevojshëm një organizatë e tillë në formën tradicionale të funksionimit. Po ashtu përqindje të madhe marrin kërkesat për lobim nga shoqëria civile, AGD dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe sugjerime për buxhetim të dedikuar grave deputete, etj.

Me rëndësi është e dhëna se 81% e grave deputete janë kundër trendit të dy legjislativave të fundit për prurjet e mëdha në politikë të "të fortëve" dhe të "biznesmenëve". Fakti është se më shumë se gjysma e tyre janë për ndryshim të sistemit zgjedhor, ndërkohë që 88% kërkojnë kuota të detyrueshme zgjedhore për gratë deputete midis 30%-50% në parlament nga modeli i kuotës së kandidimit 30% që aplikohet aktualisht.

PËR TË RRIUR PJESËMARRJEN E GRAVE NË POLITIKË	PO	JO	TJETËR
Duhet ndryshuar sistemit aktual zgjedhor	47%	53%	0%
Duhet aplikuar kuota e detyrueshme 30 ose 50% për parlamentin	88%	12%	0%
Duhet forcuar organizatat e grave brenda vetë partive politike	100%	0%	0%
Duhet forcuar lobimi tek partitë nga shoqëria civile dhe AGD	100%	0%	0%
Duhet lobim më i madh i organizatave ndërkombëtare në Tiranë	94%	6%	0%
Duhet aplikuar buxhetim i veçantë gjinor për gratë kandidate	88%	6%	6%
Duhet rritur përfaqësimi i grave në kryesinë e partive politike	93%	7%	0%
Duhet promovuar modelet e grave të suksesshme në politikë	100%	0%	0%
Duhet penguar hyrjet e "të fortëve" & "biznesmenëve" në politikë	81%	6%	13%


Sipas përgjigjeve përmbledhëse rezultojn se:

- 100% mendojnë se duhen forcuar organizatat e grave brenda partive politike
- 100% mendojnë se duhet forcuar lobimi tek partitë dhe shoqëria civile
- 100% mendojnë se duhen promovuar më shumë modelet referuese pozitive
- 94% mendojnë se duhet një lobim më i madh nga organizatat ndërkombëtare
- 93% mendojnë se duhet rritur përfaqësimi i grave në kryesitë e partive politike
- 88% mendojnë se duhet aplikuar buxhetim i veçantë gjinor në kryesitë e partive
- 88% mendojnë se duhet aplikuar kuota e detyrueshme për parlamentin
- 81% mendojnë se duhet penguar hyrja e “të fortëve” dhe “biznesmenëve” në politikë
- 53% mendojnë se duhet ndryshuar sistemi aktual zgjedhor

4.11. SUGJERIME NDAJ MONITORIMIT / AKTIVITETEVE TË ISP

Për Institutin e Studimeve Politike është shumë e rëndësishme mbledhja e vlerësimeve që vijnë nga parlamenti lidhur me raportet monitoruese dhe të gjithë aktivitetet e tjera. Marrja e vlerësimeve ndihmon në kuptimin më të mirë të perceptimit të deputetëve ndaj ISP, por edhe mund të jetë bazë për rekomandime përmirësuese në të ardhmen.

Për këtë qëllim deputetet u pyetën mbi vlerësimet që ato kanë për punën dhe raportet monitoruese të ISP. Rreth 26% e deputeteve deklaruan se kanë vlerësime pozitive për raportet dhe aktivitetin e ISP dhe nuk kanë sugjerime të veçanta.



Në përgjigjet e tjera përgjigjet dhe sidomos rekomandimet lidheshin me dy aspekte; - e para në promovimin e çështjeve gjinore: më shumë programe për integrimin gjinor (13%) dhe më shumë komunikim me gratë deputete (13%). E dyta: me raportet monitoruese në vlerësimin e deputetëve, më shumë rëndësi cilësisë sesa statistikave parlamentare (22%) dhe të vlerësohen edhe komunikimet e grave deputete në mediat sociale (9%).

Po ashtu, 9% e grave deputete kërkoi që raportet monitoruese të dërgohen paraprakisht tek deputetët përpara prezantimit final të tyre dhe daljes në publik, një sugjerim që vjen më shumë nga nevoja e deputetëve për të ndikuar në vlerësimet e tyre në raportet monitoruese, sesa nga nevoja për transparencë.

Gratë deputete u pyetën rreth vlerësimit të anketimit dhe sugjerimeve të mundshme ndaj mënyrës se si ai do të prezantohet në publik. Sipas vlerësimit të 44% të deputeteve nuk ka sugjerime dhe vlerësime të caktuara, duke marrë të mirëqenë përmbajtjen dhe formën e prezantimit të zgjedhur nga vetë ISP. Në përgjigjet e pjesës tjetër prej 56% të grave deputete, gjenden sugjerime e vlerësime, të cilat kanë vlerë për vetë sondazhin dhe për Institutin.



Konkretisht, 17% mendojnë se anketimi kishte pyetje paragjyquese, vlerësim që i adresohet disa pyetjeve që lidhen me rolin e liderit në zgjedhjen e tyre, bilancin e punës së grave deputete, vlerësimit për vështirësitë në profesion dhe elementë të karrierës politike. Po ashtu, 17% vlerësojnë se formalisht sondazhi është i gjatë në përmbajtje dhe kërkon kohë për plotësimin e tij, një kritikë e konfirmuar edhe nga të rinjtë e angazhuar në realizimin të sondazhit, por që ishte parashikuar të ishte i tillë që në fazën e parë të projektit.

Gjatë realizimit të tij të paktën katër deputete deklaruan se kërkojnë kohë në dispozicion për plotësimin e anketimit, dy prej tyre e plotësuan, ndërsa dy të tjera nuk arritën ta plotësojnë përgjatë një muaji pritjeje. Mosplotësimi nuk lidhet me anën formale, - gjatësinë e anketimit, por kryesisht me rëndësinë që deputetë të veçantë i japin praktikave të tilla të testimit apo vështirësive për të plotësuar të dhëna të caktuara personale gjatë pyetjeve specifike. Një nga personat që nuk e plotësoi është drejtuese komisioni në parlament, pozicion prej të cilit pritej të ishte mbështetëse e promovimit të problematikës së grave deputete.

Nga ana tjetër 11% e grave deputete mendojnë se të dhënat e pyetësorit duhen konsultuar me komunitetin e grave deputete përpara se të bëhet publik, duke iu druajtur paragjykit të përgjigjeve dhe gjetjeve nga media dhe pjesa tjetër përbërëse e parlamentit. Gjithashtu, 11% mendojnë se do të duhej të kishte pyetje specifike lidhur me rolin e organizatave, përfaqësive dhe network-eve ndërkombëtare, sidomos në çështjet e lobimit gjinor, trajnimit, mbështetjes së grave deputete dhe rritjes së performancës parlamentare.

5. SHTOJCË: PËRMBAJTJA E PLOTË E ANKETIMIT

A. PROFILI POLITIK

1. CILI KA QENË ANGAZHIMI JUJ POLITIK 0-2 VJET PËRPARA MARRJES SË MANDATIT TË DEPUTETES?

(zgjdh një ose më shumë alternativa të sakta)

- a) Kandidate (për kryetare bashkie / për këshillin bashkiak / për Parlament)
- b) Nuk kam pasur angazhim politik
- c) Anëtare në partinë politike
- d) Aktiviste në shoqërinë civile
- e) E zgjedhur (kryetare bashkie / në këshillin bashkiak/ Parlament)
- f) Tjetër _____

2. Nëse keni qenë më përpara dy vitesh kandidate në zgjedhjet politike, për cilin POST?

- a) Parlament
- b) Bashki
- c) Komunë
- d) Qark
- e) Poste drejtuese në parti

3. SA VITE KENI QË JENI ANGAZHUAR NË PARTI POLITIKE?

_____ Vjet

4. A KENI NDRYSHUAR ANËTARËSI NË PARTI POLITIKE?

- a) Po
- b) Jo

NËSE PO, NË CILËN/CILAT PARTI?

5. ARGUMENTI, PËRSE I JENI BASHKUAR PARTISË TUJ POLITIKE?

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) Besoni në programin dhe parimet e saj politike | PO | JO | TJETER _____ |
| b) Besoni se është mjet për promovim në karrierë | PO | JO | TJETER _____ |
| c) Besoni se mund të ndryshoni gjendjen në vend | PO | JO | TJETER _____ |
| d) Besoni se mund të siguroni një status social | PO | JO | TJETER _____ |
| e) Tjetër (Lutemi saktësojeni) | | | _____ |

6. KUR NJË GRUA DEPUTETE AKUZOHEHET / KËRCËNOHEHET PËR NJË SKANDAL, AJO DUHET:

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) T'i kërkojë mbështetje partisë së vet | PO | JO | TJETER _____ |
| b) T'i japë sqarime publikut e zgjedhësve të vet | PO | JO | TJETER _____ |
| c) T'i drejtohet medias për të nisur polemika publike | PO | JO | TJETER _____ |
| d) T'i drejtohet avokatit për kallëzim penal | PO | JO | TJETER _____ |
| e) T'i drejtohet prokurorisë për të kryer hetime | PO | JO | TJETER _____ |
| f) Tjetër _____ | | | _____ |

7. NË ZGJEDHJET E VITIT 2017, KUR JENI PËRFSHIRË NË LISTËN E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË:

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) Jeni zgjedhur përmes një gare konkurruese në parti | PO | JO | TJETER _____ |
| b) Jeni emëruar nga kryetari i partisë | PO | JO | TJETER _____ |
| c) Jeni caktuar në listë nga partitë e koalicionit | PO | JO | TJETER _____ |
| d) Keni aplikuar vetë për kandidim | PO | JO | TJETER _____ |
| e) Keni pranuar kërkesën e bazës për kandidim | PO | JO | TJETER _____ |
| f) Tjetër _____ | | | _____ |

8. SI MENDONI SE FUNKSIONON SISTEMI I KARRIERS PËR GRATË NË PARTITË POLITIKE?

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) Zgjidhen për shkak të sistemit të meritës | PO | JO | TJETER _____ |
| b) Zgjidhen për shkak të lidhjeve familjare / personale | PO | JO | TJETER _____ |
| c) Zgjidhen mbi bazën e mbështetjes nga lideri | PO | JO | TJETER _____ |
| d) Zgjidhen për shkak të sistemit të kuotave | PO | JO | TJETER _____ |
| e) Zgjidhen për shkak se aftësive profesionale | PO | JO | TJETER _____ |
| f) Zgjidhen për shkak të blerjes së postit | PO | JO | TJETER _____ |
| g) Alternativë tjetër _____ | | | _____ |

9. CILI NGA TREGUESIT E MËSIPËRM KA QENË MË PËRCAKTUES PËR KARRIERËN TUAJ POLITIKE?

10. CILI NGA TREGUESIT E MËSIPËRM KA QENË MË PËRCAKTUES PËR KARRIERËN E RIVALËVE TUAJ POLITIKË?

11. PAS MBARIMIT TË MANDATIT PARLAMENTAR, SI E SHIKONI TË ARDHMEN TUAJ?

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) Do të konkurroni përsëri në zgjedhjet parlamentare | PO | JO | TJETER _____ |
| b) Do të jepni dorëheqje nga politika | PO | JO | TJETER _____ |
| c) Keni profesion tjetër më të mirë sesa ai i politikanës | PO | JO | TJETER _____ |
| d) Do të angazhoheni me shoqërinë civile / universitetet | PO | JO | TJETER _____ |
| e) Do të angazhoheni në partinë tuaj politike | PO | JO | TJETER _____ |
| f) Nuk keni vendosur ende se cila do jetë e ardhmja | PO | JO | TJETER _____ |
| g) Alternativë tjetër _____ | | | |

12. Mesatarisht, sa orë kaloni në ditë duke u marrë me aktivitete politike në tërësi?

13. Mesatarisht, sa orë kaloni në javë në mbledhje / aktivitete me strukturat e partisë?

B: ANGAZHIMI NË AKTIVITETIN PARLAMENTAR

1. A KENI MARRË NGA KUVENDI TRAJNIMET E NEVOJSHME PËR FUNKSIONIN TUAJ PARLAMENTAR?

- a) Po
b) Jo

1.1 Nëse po:

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) A jeni trajnuar për Rregulloren dhe Statutin e Deputetit | PO | JO | TJETER _____ |
| b) A jeni trajtuar për Konfliktin e Interesit | PO | JO | TJETER _____ |
| c) A jeni trajnuar për Konsultimet publike | PO | JO | TJETER _____ |
| d) A jeni trajnuar për llogaridhënien e Transparencën | PO | JO | TJETER _____ |
| e) A jeni trajnuar për procesin e hartimit të ligjeve | PO | JO | TJETER _____ |
| f) A jeni trajnuar për Marrëdhëniet me Publikun | PO | JO | TJETER _____ |

1.2 Nëse jo,

- a) Cilat nga fushat e mësipërme janë të dobishme për ju për t'u trajnuar?

2. A KENI PROPOZUAR NDONJË LIGJ APO NISMË LIGJORE NË LEGJISLATURËN AKTUALE PARLAMENTARE?

- a) Po
b) Jo

2.1. Nëse jo, cilat kanë qenë arsyt kryesore: (Qarko përgjigjen/et)

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) Mungesa e ekspertizës personale | PO | JO | TJETER _____ |
| b) Mungesa e stafit legjislativ | PO | JO | TJETER _____ |
| c) Mungesa e kapaciteteve në grup | PO | JO | TJETER _____ |
| d) Mungesa e interesit publik | PO | JO | TJETER _____ |
| e) Bindja se kjo është detyrë e partisë | PO | JO | TJETER _____ |
| f) Bindja se nisma nuk do të miratohet | PO | JO | TJETER _____ |
| g) Frika apo presioni mbi ju | PO | JO | TJETER _____ |
| h) Opsion tjetër _____ | | | |

3. Mesatarisht, sa orë kaloni në ditë në mbledhjet e komisioneve parlamentare ose në përgatitje për këto mbledhje?

4. A ju shkakton shqetësime / pengesë në angazhimet profesionale dhe familjare angazhimi periodik në aktivitetin parlamentar? Nëse po, si e programoni kohën?

5. LIDHUR ME LIGJET QË DISKUTONI DHE VOTONI NË KUVEND?

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) A merrni paraprakisht njohuri të thelluara mbi përmbajtjen e tyre? | PO | JO | TJETER _____ |
| b) A merrni pjesë aktive në shqyrtimin e tyre në komisione? | PO | JO | TJETER _____ |
| c) A i kuptoni ligjet në formën e shkruar (gjuhën ligjore që përdoret)? | PO | JO | TJETER _____ |

- | | | | |
|--|----|----|--------------|
| d) A keni asistencën e duhur nga Kuvendi për sqarime të nevojshme? | PO | JO | TJETER _____ |
| e) A bëni konsultime paraprake me ekspertë të jashtëm mbi ligjet? | PO | JO | TJETER _____ |
| f) A bëni konsultime paraprake me zgjedhësit tuaj mbi ligjin? | PO | JO | TJETER _____ |
| g) A bëni konsultime paraprake me partinë tuaj lidhur me ligjin? | PO | JO | TJETER _____ |

6. JU SI DEPUTETE, A JU KA NDDOHUR QË NË PARLAMENT?

- | | | | |
|--|----|----|--------------|
| a) Të ndjeheni e denigruar për shkak të mendimeve politike | PO | JO | TJETER _____ |
| b) Të ndjeheni e akuzuar vetëm për shkak të bindjes politike | PO | JO | TJETER _____ |
| c) Të ndjeheni e censuruar për shkak të mendimit kritik | PO | JO | TJETER _____ |
| d) Të ndjeheni e injoruar për shkak të klimës politike | PO | JO | TJETER _____ |
| e) Të ndjeheni e abuzuar për shkak të pamjes apo veshjes | PO | JO | TJETER _____ |
| f) Të ndjeheni si fasadë në një mjedis të huaj për ju | PO | JO | TJETER _____ |
| g) Të ndjeheni e pafuqishme për t'i ndryshuar gjërat në vend | PO | JO | TJETER _____ |
| h) Të ndjeheni e parespektuar nga kolegët tuaj | PO | JO | TJETER _____ |
| i) Të ndjeheni e parespektuar nga koleget tuaja | PO | JO | TJETER _____ |
| j) Të ndjeheni viktimë e medias dhe e fake-neës | PO | JO | TJETER _____ |
| k) Të detyrohemi të flisni për gjëra që nuk besoni | PO | JO | TJETER _____ |
| l) Të detyrohemi të votoni për ligje që keni qëndrim kritik | PO | JO | TJETER _____ |

7. PËR TË QENË DEPUTETE EFEKTIVE GJATË LEGJISLATURËS, JU KENI NEVOJË:

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) Të njihni mirë Kushtetutën dhe ligjet dhe t'i referoni ato | PO | JO | TJETER _____ |
| b) Të mbani raporte të afërta me liderin politik dhe partinë tuaj | PO | JO | TJETER _____ |
| c) Të hyni në debate publike për çështje që ju besoni | PO | JO | TJETER _____ |
| d) Të mbron programin tuaj partiak dhe politik | PO | JO | TJETER _____ |
| e) Të promovoni gratë dhe të drejtat e tyre në shoqëri | PO | JO | TJETER _____ |
| f) Tjetër _____ | | | |

8. VLERËSIMI JUAJ PËR KOMISIONIN E BARAZISË GJINORË NË KUVEND

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) Nuk reflekton barazi gjinore, pasi ka vetëm një burrë deputet | PO | JO | TJETER _____ |
| b) Nuk ka impakt në forcimin e mjedisit të përfaqësimit gjinor | PO | JO | TJETER _____ |
| c) Nuk merr në shqyrtim të gjitha ligjet që lidhen me gratë | PO | JO | TJETER _____ |
| d) Nuk asistohet sa duhet nga Kuvendi dhe grupet parlamentare | PO | JO | TJETER _____ |
| e) Nuk ka ofruar ende politika imponuese/korrigjuese për qeverinë | PO | JO | TJETER _____ |
| f) Nuk ka kapacitete këshillimore dhe buxhet për aktivitete | PO | JO | TJETER _____ |

9. A jeni ndjerë e diskriminuar për shkak të gjinisë në parlament, gjatë aktivitetit dhe ushtrimit të funksionit, në debatet parlamentare apo në praktikat e tjera të punës në Kuvend? Nëse po, lutemi specifikoni raste apo praktika që krijojnë rrethana të tilla personale për ju.

10. A bën partia juaj konsultime me gratë deputete për t'u mundësuar atyre të luajnë rol të barabartë?

11. A jeni ju në gjendje të promovoni legjislacion që rrit përfaqësimin gjinor në politikë?

12. A jeni aktive në Forumin / Organizatën e Grave në partinë tuaj politike? Nëse jo, përse? Nëse po, sa e rëndësishme është kjo organizatë për karrierën tuaj politike?

13. A jeni aktive në Aleancën e Grave Deputete? Nëse po, çfarë mendoni se kjo Aleancë duhet të bëjë në dallim nga nën komisioni për barazinë gjinore?

14. A mendoni se Aleanca e Grave Deputete duhet të forcohet në kompetenca dhe në financim? Nëse po, me çfarë objektiv / justifikimi?

15. A mendoni se Aleanca e Grave Deputete promovon figura politike apo çështje gjinore? Cilat?

C: LIDHJA ME ZONËN, ZGJEDHËSIT DHE PUBLIKUN

1. ÇFARË ZONE ELEKTORALE PËRFAQËSONI NË PARLAMENT? _____

2. SI E KENI ZGJEDHUR ZONËN ELEKTORALE? (QARKONI PËRGJIGJEN E SAKTË)

- a) E keni zgjedhur vetë?
- b) Ju kanë propozuar baza e partisë?
- c) Ua ka caktuar partia juaj politike?

3. CILAT JANË TRE SHQETËSIMET KRYESORE PËR GRATË E VAJZAT VOTUESE NË ZONËN TUAJ?

- Papunësia e lartë
- Shkollimi i mangët
- Korrupsioni i lartë
- Kujdesi shëndetësor i pjesshëm
- Problemet në bujqësi dhe mjedis
- Vala e emigrimit
- Problemet me punësimin e të rinjve
- Aksesit i kufizuar në drejtësi
- Probleme të kujdesit për fëmijët
- Mungesa e qartësisë për integrimin
- Konfliktualiteti i lartë politik në vend
- Nevoja për barazi të plotë gjinore
- Tjetër _____

4. CILAT JANË TRE SHQETËSIMET KRYESORE PËR MESHKUJ T VOTUES NË ZONËN TUAJ?

- Papunësia e lartë
- Shkollimi i mangët
- Korrupsioni i lartë
- Kujdesi shëndetësor i pjesshëm
- Problemet në bujqësi dhe mjedis
- Vala e emigrimit
- Problemet me punësimin e të rinjve
- Aksesit i kufizuar në drejtësi
- Probleme të kujdesit për fëmijët
- Mungesa e qartësisë për integrimin
- Konfliktualiteti i lartë politik në vend
- Nevoja për barazi të plotë gjinore
- Tjetër _____

5. LIDHUR ME AKTIVITETIN DHE KOMUNIKIMIN TUJ PUBLIK

- a) Sa herë në muaj zhvillonit takime me zgjedhësit tuaj? _____
- b) Sa herë në muaj jepni intervista në media të ndryshme? _____
- c) Sa herë në muaj takoheni me grupet e interesit në zonën tuaj? _____
- d) Sa herë në muaj takoheni me përfaqësues ndërkombëtarë? _____
- e) Sa herë në muaj ftoheni dhe merrni pjesë në debate televizive? _____
- f) Sa herë në muaj jeni ftuar në aktivitete nga bashkia në zonën tuaj? _____

6. NGA PËRVOJA JUJ, LIDHJA E DEPUTETËVE ME ZONËN ELEKTORALE (QARKONI PËRGJIGJEN E SAKTË OSE KOMENTONI MBI

ALTERNATIVAT NË PËRGJIGJE)

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) Është më e vështirë për gratë deputete sesa burrat deputetë | PO | JO | TJETER _____ |
| b) Është më e vështirë kur zona dominohet nga njësi rurale | PO | JO | TJETER _____ |
| c) Është më e vështirë kur përfaqësoni një zonë të varfër | PO | JO | TJETER _____ |
| d) Është më e vështirë kur në zonë nuk ka media lokale | PO | JO | TJETER _____ |
| e) Është më e vështirë kur pushteti lokal i përket partisë tjetër | PO | JO | TJETER _____ |
| f) Është më e vështirë kur nuk ka asnjë ministër nga ajo zonë | PO | JO | TJETER _____ |

7. CILAT MENDONI SE JANË METODAT MË EFEKTIVE PËR KOMUNIKIM ME ELEKTORATIN? (shënoni nga 1 në 8, sipas rëndësisë, ku 1 është shumë e rëndësishme, 8 më pak e rëndësishme)

- Komunikimi përmes takimeve direkte
- Komunikim përmes shërbimit postar
- Komunikim përmes telefonit
- Komunikim përmes e-mail-it
- Komunikim përmes rrjeteve sociale
- Komunikim përmes medieve

- Komunikim përmes zyrës së partisë
- Komunikim përmes stafit asistues

8. NË FUNKSIONIN E DEPUTETES SË KUVENDIT, A KENI? (Qarkoni përgjigjet që janë "Po" për ju)

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) Zyrë elektorale për aktivitet dhe takime | PO | JO | TJETER _____ |
| b) Zyrë në Kuvend për aktivitet dhe takime | PO | JO | TJETER _____ |
| c) Këshilltarë ndihmës që ju asistojnë | PO | JO | TJETER _____ |
| d) Financim të mjaftueshëm për aktivitetin tuaj | PO | JO | TJETER _____ |
| e) Staf mbështetës nga partia juaj | PO | JO | TJETER _____ |
| f) Sponsorime nga mbështetës të partisë tuaj | PO | JO | TJETER _____ |
| g) Adresë publike për t'ju kontaktuar | PO | JO | TJETER _____ |
| h) E-mail zyrtar për t'ju kontaktuar | PO | JO | TJETER _____ |
| i) Profil zyrtar për komunikim në Facebook? | PO | JO | TJETER _____ |
| j) Profil zyrtar për komunikim në Instagram? | PO | JO | TJETER _____ |
| k) Profil zyrtar për komunikim në Twitter? | PO | JO | TJETER _____ |

9. A JENI DAKORD ME PERCEPTIME PUBLIKE, TË TILLA SI:

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) Gratë janë menaxhere politike më të afta sesa burrat | PO | JO | TJETER _____ |
| b) Gratë në politikë duhet të sakrifikojnë për karrierën | PO | JO | TJETER _____ |
| c) Gratë në politikë janë më shumë produkt kuotash sesa meritash | PO | JO | TJETER _____ |
| d) Gratë në politikë kanë sjellë ndryshime pozitive për vendin | PO | JO | TJETER _____ |
| e) Gratë në politikë janë më pak të korruptuara sesa burrat | PO | JO | TJETER _____ |
| f) Gratë ministre janë më të afta se burrat ministra | PO | JO | TJETER _____ |
| g) Gratë drejtuese në komisione janë më të afta se burrat drejtues | PO | JO | TJETER _____ |
| h) Gratë në parlament flasin më profesionalisht se burrat deputetë | PO | JO | TJETER _____ |
| i) Gratë në politikë janë më pak të inkrimnuara se burrat | PO | JO | TJETER _____ |
| j) Gratë me fëmijë kanë kufizime në ushtrimin e politikës | PO | JO | TJETER _____ |
| k) Gratë deputete duhet të caktohen vetëm në zonat urbane | PO | JO | TJETER _____ |
| l) Mjedisi politik në Shqipëri është pengues për gratë në karrierë | PO | JO | TJETER _____ |
| m) Mjedisi publik në Shqipëri është paragjykses për gratë në karrierë | PO | JO | TJETER _____ |
| n) Media në Shqipëri është spekuluese për gratë në karrierë | PO | JO | TJETER _____ |

10. PËR TË RRITUR PJESËMARRJEN E GRAVE NË POLITIKË MENDONI SE:

- | | | | |
|---|----|----|--------------|
| a) Duhet ndryshuar sistemit aktual zgjedhor | PO | JO | TJETER _____ |
| b) Duhet aplikuar kuota e detyrueshme 30 ose 50% për parlamentin | PO | JO | TJETER _____ |
| c) Duhet forcuar organizatat e grave brenda vetë partive politike | PO | JO | TJETER _____ |
| d) Duhet forcuar lobimi tek partitë nga shoqëria civile dhe Aleanca e Grave | PO | JO | TJETER _____ |
| e) Duhet lobim më i madh i organizatave ndërkombëtare në Tiranë | PO | JO | TJETER _____ |
| f) Duhet aplikuar buxhetim i veçantë gjinor për gratë kandidate | PO | JO | TJETER _____ |
| g) Duhet rritur përfaqësimi i grave në kryesinë e partive politike | PO | JO | TJETER _____ |
| h) Duhet promovuar më shumë modelet e grave të suksesshme në politikë | PO | JO | TJETER _____ |
| i) Duhet penguar hyrjet e "të fortëve" dhe "biznesmenëve" në politikë | PO | JO | TJETER _____ |

10. Në fushatë elektorale, a jeni ndjerë e diskriminuar në burime financiare e teknike për fushatë apo në retorikën ndaj jush apo në kapacitetet mbështetëse për një fushatë të suksesshme?

10. A keni ndeshur ndonjë vështirësi specifike në kandidimin për poste politike apo në ushtrimin e detyrës suaj si deputete në Kuvend për shkak të gjinisë? Ju lutem specifikoni në detaje.

10.1. Nëse po, si i keni kapërcyer këto barriera/vështirësi?

11. A keni ndonjë kritikë / sugjerim për organizata si Instituti i Studimeve Politike, në lidhje me raportimet tona mbi punën e deputeteve në parlament?

12. A keni ndonjë sugjerim shtesë për problematikën, të cilat mendoni se nuk janë trajtuar e mund të trajtoheshin në këtë pyetësor?

Ju faleminderit për kohën dhe përgjigjet!

MBI INSTITUTIN E STUDIMEVE POLITIKE

Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al) është një organizatë e shoqërisë civile që vepron në fushën e demokratizimit dhe shtetit të së drejtës. Drejtor Ekzekutiv aktual është Prof. Afrim Krasniqi. ISP është e fokusuar në monitorimin e institucioneve demokratike, si dhe në hartimin e raporteve / analizave profesionale mbi problematika specifike politike me interes për qytetarët, shoqërinë dhe partnerët ndërkombëtarë. Pjesë e ISP janë ekspertë të njohur të zhvillimeve politike dhe të drejtësisë, të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të marrëdhënieve publike. ISP publikon vazhdimisht raporte monitoruese.

DISA NGA PROJEKTET KRYESORE TE REALIZUARA VITET E FUNDIT NGA ISP:

- Database www.deputetim.al mbi monitorimin e Kuvendit të RSH (2017-2020)
 - Database <http://dekriminalizimi.isp.com.al/> mbi monitorimin e ligjit 138/2015 (2019-2022)
 - Monitorim të standardeve të etikës dhe Konfliktit të Interesit në parlament (2019-2020)
 - Monitorim të përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë elektorale (2019-2020)
 - Monitorim të reformës në drejtësi dhe progresit të integritetit (nga 2016 dhe në vijim)
 - Database online www.muzeumemories.info Shqipëria në periudhën komuniste
 - Database www.politike.al mbi partitë politike, zgjedhjet, organizimin e tyre, 2016-2017
 - Database www.vota.al mbi votën dhe subjektet zgjedhore 1991-2017
 - Monitorimin e demokracisë së brendshme në partitë politike (nga 2015). Raporte vjetore periodike
 - Monitorimin e reformës zgjedhore dhe komentari (broshurë) mbi ligjin "Mbi partitë politike"
 - Monitorimi i përfaqësimit të grave në partitë politike (2017) dhe në zgjedhjet lokale 2015
 - Monitorim i zonave zgjedhore të riskut dhe të përfshirjes së elementëve të inkriminuar 2015-2019.
 - Monitorim i qeverisë me ministra teknikë dhe botim profesional me gjetjet (2017-2018)
 - Monitorim të Kuvendeve Kombëtare të partive kryesore. Anketime dhe raporte mbi gjetjet
 - Monitorimin e ligjit mbi të drejtën e informimit (nga 2014 dhe në vijim)
 - Monitorim të ligjit mbi qeverisjen vendore dhe efektet me ndarjen e re (nga 2016 dhe në vijim)
- ❖ Raporti do të shpërndahet në rrugë elektronike dhe të printuar të gjithë deputetëve në parlament, partive politike parlamentare, partnerëve të ISP, ekspertëve të angazhuar, si dhe mediave kryesore.
 - ❖ Të gjitha publikimet e ISP që lidhen me projekte kombëtare e ndërkombëtare (libra, studime, policy paper, raporte, etj) jepen falas për çdo të interesuar, si dhe publikohen në faqen zyrtare të ISP në formë të përmbledhur
 - ❖ Për çdo interes, sugjerim apo informacion, mund të kontaktoni në çdo kohë ISP përmes adresës zyrtare, e-mailit, faqes së internetit, adresave të ISP në rrjetet sociale, etj.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Gratë deputete: roli, modelet dhe sfida të përfaqësimit : anketim me gratë deputete: Kuvendi i Shqipërisë : 2019-2020 / dr. i projektit Afrim Krasniqi. Tiranë : Instituti i Studimeve Politike, 2020... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-4592-4-4

- 1.Parlamenti shqiptar
 - 2.Deputetë
 - 3.Gra politkane
 - 4.Monitorime
 - 5.Shqipëri
- 328 -055.2(496.5)



www.isp.com.al
www.deputetim.al